

Kompania Rajonale e Ujësjetlësit
 "Hidroregjioni Jugor" SH.A.
 "Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren
 Tel/Fax: 029/ 244-150 029/ 244-107
 E-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2020 mori këtë:

RAPORTI VJETOR-2019

Vendimi : 01-59/01

Bordi i Drejtorëve miratoi raportin vjetor për vitin 2019 në mbledhjen e LIV (54) të mbajtur me datë 28.02.2020.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Besim Baraliti	Kryesuesi i BD Rexhep Manxhuka
Nënshkrimi		
Data	28.02.2020	28.02.2020





2019

RAPORT VJETOR



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

info@hidroregjioni-jugor.com

konsumatori@hidroregjioni-jugor.com

1.Përmbajtja


Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	4
2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE	6
2.1 Të dhënat kryesore gjatë vitit 2019	6
2.2 Te dhenat per drejtot jo- ekzekutiv	8
2.2.1 Emrat e drejtove te bordit te drejtove	8
2.2.2 Numri i takimeve te bordit te drejtove	9
2.2.3 Numri i takimeve te komiteteve te bordit	9
2.2.4 Informacionet e tjera te bordit gjate vitit	10
2.3 Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividenden	20
2.4 Kredit e rendesishme te nenshkruara apo paguara gjate vitit	20
2.5 Investimet gjate vitit 2019	20
2.6 Dividentat e paguara gjate vitit 2019	20
3 RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV	21
3.1 Ngjarjet kryesore te vitit	21
3.1.1 Aktivitetet nga Shërbimi Teknik	21
3.1.2 Situata e furnizimit – NJ.P. - Janar –Dhjetor 2019	21
3.1.3 Aktivitetet kryesore	21
3.1.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	29
3.1.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	29
3.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	29
3.2 Pasqyrat e performancave operative nga Shërbimi Teknik	30
3.2.1 Prodhimi – Janar-Dhjetor 2015-2019	30
3.2.2 Prodhimi – TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	31
3.2.3 Prodhimi – GJM1-GJM2 -2019	32
3.2.4 Prodhimi – Realicimi i caqeve -2019	32
3.3 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	33
3.3.1 Aktivitetet kryesore- Janar –Dhjetor 2019	33
3.3.2 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shkyqjes	33
3.3.3 Raport I ankesave teknike dhe komerciale	34

3.3.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	35
3.3.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	35
3.3.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	36
3.3.7	Aktivitetet për zvoglimin e UPF-se	36
3.4 Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Nr. I Faturave		
3.4.1	Numri i Faturave- 2016-2019	37
3.4.2	Numri i Faturave - TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	39
3.4.3	Numri i Faturave- GJM1-GJM2 -2019	40
3.4.4	Numri i Faturave- Janar-Dhjetor-2019 (Caqet – PB-2019)	41
3.5 Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Faturimi – m3		
3.5.1	Faturimi – m3- 2015-2019	42
3.5.2	Faturimi – m3- TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	44
3.5.3	Faturimi – m3 -GJM1-GJM2 -2019	46
3.5.4	Faturimi – m3- Janar-Dhjetor-2019 (Caqet – PB-2019)	47
3.6 Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë- Faturimi – €		
3.6.1	Faturimi €- 2017-2019	48
3.6.2	Faturimi €- TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	50
3.6.3	Faturimi € -GJM1-GJM2 -2019	51
3.6.4	Faturimi €- Janar-Dhjetor-2019 (Caqet – PB-2019)	52
3.7 Performancat nga Shërbimi për Konsumatorë - Arkëtimi – €		
3.7.1	Arkëtimi €- 2015-2019	53
3.7.2	Tarifat €- 2015 -2019	54
3.7.3	Arkëtimi €- TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	55
3.7.4	Arkëtimi € -GJM1-GJM2 -2019	57
3.7.5	Arkëtimi €- Janar-Dhjetor-2019 (Caqet – PB-2019)	58
3.8 Raporti nga Shërbimi financiar		
3.8.1	Aktivitetet kryesore - Janar –Dhjetor 2019	59
3.8.2	Arsyeshmëria e shpenzimeve	60
3.8.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	61
3.8.4	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	61
3.8.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	61

3.9	Performancat Financiare - Shpenzimet €	62
3.9.1	Shpenzimet € - 2016-2019	62
3.9.2	Shpenzimet € - TM1-TM2-TM3-TM4 -2019	63
3.9.3	Shpenzimet € - GJM1-GJM2 -2019	64
3.9.4	Shpenzimet € - Janar-Dhjetor -2019 (Caqet- PB- 2019)	65
4	Personeli	66
4.1	Personeli – Janar-Dhjetor 2016-2019	66
4.2	Personeli – Janar-Dhjetor – 2019 (CAQET- PB-2019)	66
5	TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCAVE	67
5.1	Performancat – Janar-Dhjetor - 2019	67
5.2	Performancat – 2015- 2019	68
5.3	Performancat – TM1-TM2-TM3-TM4 - 2019	69
5.4	Performancat – GJM1-GJM2 - 2019	70
5.5	Performancat – Janar-Dhjetor – 2019 (Caqet – PB – 2019)	71
6	Aktivitetet e Departamentit Administrativ	72
6.1	Aktivitet kryesore	72
6.2	Raport i zyres ligjore	78
6.3	Lendet qe rrezikojne Kompanine	85
7	RAPORT I AUDITORIT	91
7.1	Raport i auditorit te brendshem	91
8	KTIVITETET E ZYRËS SË PROKURIMIT	94
9	TRANSAKSIONET KRYESORE	102
10	PASQYRAT FINANCIARE	103
11	Prespektiva per vitin e ardhshëm	110
12	Rreziqet e të ardhmes	111
13	Investimeve e realizuara – Janar-Dhjetor 2019	112
14	Plani I investimeve kapitale- kanalizim per vitin 2020	114
15	Raportet nga Menagjeret e projekteve	120
	ORGANOGRAMI	132

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit,viti 2019



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
64	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
129	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

2. RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

2.1 Të dhënat kryesore gjatë vitit

FURNIZIMI

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regjional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania ka arritur që në muajt Janar-Dhjetor të vitit 2019 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në dite. Sa i përket pjesës së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, lagjen Dardania, lagja 2 Korriku që nga muaji Qershor janë eliminuar komplet reduktimet dhe këto lagje kanë furnizim të rregullt me ujë të pijes. Në muajt Korrik dhe Gusht kemi aplikuar reduktime në fshatrat e komunës së Prizrenit. Për me gjerësisht është prezentë tabela e reduktimeve nga njësia Operuese në Prizren të cilën munde ta gjeni në webfaqen e kompanisë.

Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes mirëpo duke u bazuar në raportet e njësive operuese kemi aplikuar reduktime të planifikuara në varësi të defekteve të mundshme si dhe ndërprerjeve të enrgjise elektrike nga KEDS *(për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njësive Operative nga udhëheqësit e Njësive)*.

UJI I PRODHUAR

Për muajt Janar-Dhjetor 2019 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit **16,653,327.00 m³**, krahasuar me vitin 2018 kemi një rënie të prodhimit të ujit të pijes prej **384,965.00 m³. (-2.26%)**

FATURIMI - m3

Gjatë vitit 2019 në nivel regjional janë faturuar **7,347,785 m³** me një rënie të faturimit prej **- 19.071 m³ (- 0.26%)** krahasuar nga viti 2018.

FATURIMI - €

Gjatë vitit 2019 në nivel regjional janë faturuar **4.819.869,08 €** me një rritje të faturimit prej **+453.001,92 € (+10.4%)** krahasuar nga viti 2018.

ARKËTIMI - €

Gjatë vitit 2018 në nivel regjional janë arkëtuar **4.560.581,02 €** me një rritje të arkëtimit prej **+409.298,49 € (+9.86%)** krahasuar nga viti 2018.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falënderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogëlimin e UPF-se.

Kompania në nivel regjional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe rregullimin me kohë të defekteve në tërësi.

Shërbimi Teknik me të gjithë sektorët e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për rregullimin e defekteve sa më shpejtë.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regjional për Janar-Dhjetor, 2019 është **55,88** ose **0.98%** me rënie të UPF-së nga viti 2018.

SHPENZIMET - €

Gjatë vitit 2019 në nivel regjional shpenzimet kanë arritur në **3.977.437,12 €** me një rritje të shpenzimeve prej **+130.842,08 € (+6.80%)** krahasuar nga viti 2018.

MBULIMI OPERATIV

Gjatë vitit 2019 në nivel regjional Kompania ka arritur të ketë mbulim operativ prej 1.15 apo +583.143,42 € mbi shpenzimet

2.2 TË DHËNAT PËR DREJTOR – JO- EKZEKUTIV

2.2.1 Emrat e drejtorëve të bordit të drjetorëve

Rexhep Manxhuka

Kryesues i Bordit

Mob.: 045 / 223 563

044 / 163 120

e-mail: rexhep-manxhuka@hotmail.com**Ridvan Hoxha**

Anëtar i Bordit

Mob.: 049/ 560 007

e-mail: rhoxha7@hotmail.com**Alban Zulfaj**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 290 047

049 / 290 047

e-mail: alban_zulfaj@hotmail.com**Ylber Kuqi**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 303 372

e-mail: ylber.kuqi@rks-gov.net / belkuqi@hotmail.com**Ramadan Abazi**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 256 905

e-mail: r-abazi@hotmail.com**Reshit Makica**

Anëtar i Bordit

Mob.: 044 / 184 528

e-mail: reshitmakica@hotmail.com**Besim Baraliu**

Anëtar i Bordit

(Kryeshef Ekzekutiv)

Tel.&Fax.: 029 / 244 150 Mob.: 045 / 322 131

e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

2.2.2 Numri i takimeve të bordit gjatë vitit 2019

MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE

K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	28.01.2019	Prizren	
2	27.02.2019	Prizren	
3	01.04.2019	Prizren	
4	30.04.2019	Prizren	
5	30.05.2019	Prizren	
6	19.06.2019	Prizren	MPVA
7	29.07.2019	Prizren	
8	27.09.2019	Prizren	
9	25.10.2019	Prizren	
10	27.11.2019	Prizren	
11	24.12.2019	Prizren	

2.2.3 Numri i takimeve të Komitetit te Auditimit gjatë vitit 2019

MBLEDHJET E KOMISIONIT TË AUDITIMIT

K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

NR.	DATA	VENDI	VËREJTJE
1	25.01.2019	Prizren	
2	25.02.2019	Prizren	
3	25.03.2019	Prizren	
4	27.05.2019	Prizren	
5	26.07.2019	Prizren	
6	25.09.2019	Prizren	
7	23.10.2019	Prizren	
8	25.11.2019	Prizren	

2.2.4 Informacione të tjera të bordit gjatë vitit 2019

KUR Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve të emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin Nr.11/56 të datës 30.10.2015. Bordi përbëhet nga 6 drejtorë. Komisioni i auditimit përbëhet nga 3 anëtarë.

Gjatë vitit 2019 Bordi i Drejtoreve ka mbajtur 11 takime të rregullta mujore, sipas procesverbaleve takimet e Bordit janë mbajtur me këto data: 28.01.2018; 27.02.2019; 01.04.2019; 30.04.2019; 30.05.2019; 19.06.2019 (MPVA); 29.07.2019; 27.09.2019; 25.10.2019; 27.11.2019; 24.12.2019.

Në këto takime angazhimet e bordit kanë të bëjnë me:

- Miratimin e raportit vjetor për vitin 2018
- Aprovimi i Revidimit të Plan-Biznesit për vitin 2019-2021.
- Aprovimi i Plan Biznesit per vitin 2020-2022.
- Raportet e Zyrtarit të auditimit të brendshëm.
- Është mbajtur Mbledhja së Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në K.R.U."Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren (për vitin 2018).
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 28.01.2019 Në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i K.R.U" Hidroregjioni Jugor"Sh. A, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar të TM-4 për vitin 2018.
- Bordi i Drejtorëve pas shqyrtimit të rekomandimeve të dala nga Komisioni për regjistrim vjetor 2018 Rekomandoj që të formohet një komision për evitimin e mjeteve të amortizuara (regjistër të mjeteve) dhe të paraqitet në Bord.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 27.02.2019 në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet vjetore dhe tremujore , Bordi i Drejtorëve pas shqyrtimit të bërë **miratoi** Raportin vjetor Operativ dhe Financiar për vitin 2018.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 01.04.2019 Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit"Hydroregjioni Jugor"Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 29 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Raportet mbi Përbushjen e Nevojave të Klientëve dhe nenin 16 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, pas shqyrtimit të bërë anëtarët e Bordit të Drejtorëve që ishin të pranishëm njëzëri

miratuan raportin mbi Hulumtimin e Kënaqshmërisë së Konsumatorëve për periudhën janar-dhjetor 2018 në zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren.

- Bordi i Drejtoreve ne takimin e mbajtur me 30.04.2019 Bordi i Drejtoreve kërkon nga të gjitha Njësitë Punuese të KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren, që në afatin kohor prej 60 ditëve të përpilojnë një raport përfundimtar për konsumatorët fiktiv apo me konsum 0. Pas 60 ditëve ky raport ti prezantohet Bordit të Drejtoreve dhe Komisionit të Auditimit.
- Në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtoreve i K. R. U" Hidroregjioni Jugor "Sh. A, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar të TM1 për vitin 2019.
- Bordi i Drejtoreve bëri vlerësimin e kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët ë Lartë të Kompanisë për vitin 2018: **Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar, Sekretaren e Kompanisë ndërsa nga Komisioni i Auditimit u vlerësua Auditori i Brendshëm i Kompanisë.**

Me komentet e vlerësimit të performancës së përgjithshme të kryerjes së detyrave të punës për Zyrtarët e Lartë të Kompanisë u pajtuan të gjithë anëtarët prezent të Bordit të Drejtoreve të KRU "Hidroregjioni Jugor"sh.a Prizren.

- Bordi i Drejtoreve kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të mirret parasysh lista e punëtoreve e përpiluar nga komisioni i përbashkët në mes KRU "Hidroregjioni Jugor" sh,a Prizren dhe Minsitrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Kjo listë ka qenë e pranuar edhe MPMS konform vendimit të këtij komisioni dhe të njëjtit të fillojnë punen.
- Në takimin e mbajtur me 30.05.2019 Bordi i Drejtoreve kërkoj nga shërbimet përkatëse që të punojnë në zvogëlim të humbjeve te ujit, ekipet e inspektoratit te Kompanisë të rrisin efikasitetin e punës në përgjithësi si dhe të punohet në vet-disimin e qytetarëve për mënyrën e pagesës se ujit nëpër portoarkat e Kompanisë.

Kryesuesi i Bordit kërkoj që të merren seriozisht vërejtët dhe sugjerimet e dhëna nga Bordi i Drejtoreve.

- Bordi i Drejtoreve ne takimin e mbajtur me 19.06.2019 Bordi i Drejtoreve pas shqyrtimit të Raportit të Auditorit për Pasqyrat financiare të Audituarra për 2018 ishin të pakënaqur me opinionin e dhënë nga ZKA në raport të auditimit për Kompaninë andaj sugjeruan menaxhmentin e Kompanisë që rekomandimet e dhëna nga auditori i ZKA të implementohen me kohë dhe mos të përsëriten të gjeturat.

- Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen Përgjithshme Vjetore me Aksionarin i **miratoi** Pasqyrat Financiare të Audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2018.
- Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin e **miratoi** Raportin vjetor për vitin 2018.
- Bordi i drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin e **miratoi** Performancën e Menaxhmentit të Kompanisë për vitin 2018.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me 29.07.2019 vendosi që Deklarata për politiken e Kompenzimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU”Hidroregjionit Jugor “sh.a Prizren të aprovohet pasi të kemi koment nga NJPMNP.
- Bordi i Drejtorëve **rekomandoi** menaxhmentin e kompanisë bashkë me Udhëheqësit e Njësive Punues, kontrollen, inkasantet dhe inxhinieret e kompanisë që të vazhdojnë në nivel regional të kompanisë nismen e filluar në verifikimin e konsumatoreve pa ujëmatës në Zhur si pilot projekt me qëllim që të jap rezultate sa më pozitive.
- Bordi i Drejtorëve i K.R.U”Hidroregjioni Jugor” Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2019 **miratoi** raportin e TM-2 për vitin 2019 në mbledhjen e XLVII të mbajtur me datë 29.07.2019.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës”Hidroregjioni Jugor”Sh. A me seli në Prizren në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, për Plan-Biznes në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2019 njëzëri **miratoi** revidimin e Planit të biznesit për vitin 2019 në mbledhjen e XLVII të mbajtur me datë 29.07.2019.
- Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 17.09.2019 kërkoi nga shërbimet përkatëse të Kompanisë që deri me datë 10.10.2019 të dorëzohen të gjitha shënimet e kërkuara për PB-2020 të Zyrtarit për raportim dhe plan biznes, përndryshe do të kërkohet nga Kryeshefi Ekzekutiv që të marr masa disiplinore ndaj shërbimeve përkatëse.
- Bordi i Drejtorëve pasi shqyrtoi ankesën e punonjësit të Kompanisë Zef Ndrejaj që i është ndërruar vendi i punës, ndaj Ankesës së tij **Refuzohet ankesa si e pabazuar**, me arsyetimet si më poshtë: Ndërrimi i vendit të punës suaj nga Kryeshefi Ekzekutiv është bërë në pajtim me Ligjin, Nr. 03/L-212, i Punës; Vendimi për përcaktimin në vend të punës Punëtorë në shërbimin e kontrollës / Inspektoratit në Njësinë Punuese në Prizren, me datë 15.07.2019 është pranuar nga ana juaj, gjë e cila vërtetohet edhe me nënshkrimin tuaj në Vendimin Nr. 1965, datë 02.07.2019 si dhe është nënshkruar nga punonjësi në fjalë edhe kontrata e punës sipas këtij vendimi.
- Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetës”Hidroregjioni Jugor”Sh.A pas shqyrtimit të kërkesës së përbashkët të parashtruar nga Udhëheqësi njësisë së Suharekës dhe Malishevës për plotësim të rregullores për sistematizimin e vendeve

te punës, **miratoi** kërkesën e Udhëheqësit të Suharekës dhe të Malishevës për plotësim të rregullores për sistematizimin e vendeve të punës edhe me pozitën e punës të Udhëheqësit të Inspektoratit / kontrollës në njësinë e Suharekës dhe të Udhëheqësit të Inspektoratit / kontrollës në njësinë e Malishevës.

- Detyrat dhe përgjegjësit e Udhëheqësit të Inspektoratit të njësisë së Suharekës dhe të Malishevës do të jenë pjesë përbërëse të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor” Sh. A.- Prizren.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 25.10.2019 në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për raportet tremujore dhe nenin 18 Ligji Nr. 04/L-111 Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtoreve i K. R. U” Hidroregjioni Jugor ”Sh.A, pas shqyrtimit të bërë njëzëri **miratoi** Raportin Operativ dhe Financiar të TM3 për vitin 2019.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 25.10.2019 aprovoi njëzëri që të bëhen Departamente: 1.Impianti i ujërave të zeza dhe 2.Shërbimi me Konumatorë, ndërsa, propozimi për departament të ri të Cilësisë së Ujit nuk u aprovua.
- Bordi i Drejtoreve i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit”Hidroregjioni Jugor”Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 për Plan-Biznes, mori këtë pas shqyrtimit të bërë **miratoi** Plan - Biznesin për vitin 2020-2022.
- Bordi i Drejtoreve në takimin e mbajtur me datë 27.11.2019 pas diskutimit dhe shqyrtimit të bërë Bordi i Drejtoreve miratoi kërkesën e Kryeshefit Ekzekutiv për ndarjen e shpërblimit për Bordin e Drejtoreve si dhe për të gjithë të punësuarit për nder të 28 Nëntorit Ditës së Flamurit Kombëtar me nga 60.00€ dhe për vitin e Ri 2020 me nga 30.00€.
- Bordi i Drejtoreve rekomandon menaxhmentin e Kompanisë që të ju bëjnë apel punëtorëve të pajtohen që vlera e shpërblimit e 28 Nëntorit të epet në ndihmë dhe solidaritet ndaj familjeve të dëmtuara nga tërmeti në Shqipëri.
- Bazuar në nenin 34 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, me qëllim të harmonizimit të shprehjeve të caktuara, të përdorura në aktet nënligjore të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Hidroregjioni Jugor”sha, Bordi i Drejtoreve të KRU “Hidroregjioni Jugor”sha aprovoi njëzëri **RREGULLOREN NR. 06/2019 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E, RREGULLORES NR. 01/2017, RREGULLORES NR. 03/2017, RREGULLORES NR. 04/2017 DHE RREGULLORES NR. 05/2017.**

- Bordi i drejtorëve ne takimin e dates 24.12.2019 e ndërpreu vazhdimin e takimit për shkak se nga Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë nuk është duke respektuar rekomandimi e Bordit i marr në takimin e datës 27.11.2019 për shpërblim të punëtorëve për nder te 28 Nëntorit dhe për vitin e Ri 2020.

Aktivitetet tjera të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2019

- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2019 ishte në kontakte të vazhdueshme me Menaxhmentin e Kompanisë.
- Në vazhdimësi ka kërkuar dhe është njoftuar, në kontakte direkte por edhe në formë të shkruar, për gjendjen dhe zhvillimet në kompani.
- Është mbikqyrë menaxhimi kompanisë dhe janë dhënë këshillat e nevojshme për Kryeshefin Ekzekutiv.
- Në takimet e rregullta janë mbikqyrë të gjitha ecuritë e biznesit, mbarëvajtja e tyre sipas vendimeve të Bordit si dhe aspekti ligjorë i vendimeve të Menaxhmentit të kompanisë. Lidhur me këtë Bordi i Drejtorëve është i informuar për të gjitha vendimet dhe zhvillimet e rëndësishme.
- Është bërë shqyrtimi dhe aprovimi i raporteve tremujore për vitin 2019 (duke u bazuar në raportet mujore); dhe në kornizën ligjore të Ligjit për NP.
- Janë dorëzuar të aprovuara raportet si në vijim: Raporte tremujore për aksionarin (MZHE); (nga raporti TM1 deri te raporti për TM4) dhe raporte mujore për ARRU-në.
- Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2019 i ka mbajtur 11 takime të rregullta me përbërje të plotë.
- Në kuadër të Bordit të drejtorëve kanë vazhduar të funksionojnë këto komitete;
 1. Komisioni i Auditimit (08 Takime)
 2. Komiteti për Staf dhe Shbërblime (0 takime)
 3. Komiteti i Financave (0 Takime)
 4. Komiteti për hulumtime dhe teknologji (0 Takime)

Bordi i Drejtorëve falënderon Kryeshefin Ekzekutiv, stafin menaxhues të Kompanisë dhe gjithë punëtorët për për angazhimin e tyre në rritjen e performancave të kompanisë dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve. Bordi shprehë një mirënjohje të veçantë për të gjithë donatorët (KFW, Dorsch-CDI), MZHE dhe Komunitat për bashkëpunim dhe mbështetje në realizimin e shumë projekteve për në interes të Kompanisë.

Aktivitetet e Komisionit të Auditimit, gjatë vitit 2019.

Raporti vjetor i Komisionit të Auditimit, të KRU" Hidroregjioni Jugor"SHA, Prizren, në formë përmbledhëse përfshinë aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2019. Bazë apo burim i të dhënave gjatë përgatitjes së këtij raporti vjetor, janë procesverbalet zyrtare të mbajtura nga ana e Sekretares së kompanisë.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2018 ka mbajtur gjithsejt 8 takime të rregullta, ndërsa shumë çështje tjera janë shqyrtuar drejtëpërdrejt në takimet e rregullta të Bordit të Drejtorëve. Takimet janë mbajtur gjatë këtyre datave: 25.01.2019; 25.02.2019; 25.03.2019; 27.05.2019; 26.07.2019; 25.09.2019; 23.10.2019, dhe 25.11.2019.

Në vazhdim, në mënyrë kronologjike, në formë të përgjithësuar, janë të paraqitura takimet, aktivitetet, diskutimet, konkluzionet dhe vendimet e Komisionit të Auditimit.

1. Në takimin e parë të vitit 2019, të mbajtur me 25.01.2019 nga Komisioni i Auditimit, është diskutuar dhe analizuar:

- Performanca operative e financiare dhjetor 2018,
- Raportet e auditorit të brendshëm për TM4 2018.
- Raporti mbi obligimet financiare të kompanisë ndaj operatoreve ekonomik.
- Raporti mbi procedurat me përmbaruesit privat sipas njësive dhe inkasimet e deritanishme nga këto procedura.
- Shqyrtimi i Planit Strategjik të punës së Auditorit të Brendshëm, për periudhën 2019-2021, i Planit Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2019 si dhe Statuti i Auditimit të Brendshëm.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit pas shqyrtimit të raportit të muajit dhjetor 2018 konstatoj se performanca e Kompanisë është pozitive andaj e aprovoj raportin si të tillë.
- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM4 të Punës së Auditorit të Brendshëm, për vitin 2018.
- K.A kërkoj nga departamentet dhe shërbimet përkatëse të Kompanisë të i adresojnë të gjeturat e Auditorit të Brendshëm dhe t'i zgjidhin deri në një periudhë vijuese prej 6 muajve.
- K.A kërkoj nga Zyra për Konsumator të përpilohet lista e konsumatoreve me borxhet më të mëdha për amvisëri dhe biznese.
- Komisioni i Auditimit kërkoj nga Zyra për Konsumator dhe Zyra Ligjore të raportohet në mënyrë të specifikuar në baza tremujore për lëndët që dergohen te Përbaruesi Privat.
- Komisioni i Auditimit njëzëri aprovoj Planin Strategjik të punës së Auditorit të Brendshëm, për periudhën 2019-2021, të Planit Vjetor të Punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2019 si dhe Statutin e Auditimit të Brendshëm.

2. Takimi i dytë i K.A është mbajtur me datë 25.02.2018, ku është diskutuar:

- Performanca operative e financiare janar 2019,
- Te paraqitet deklarata e TVSH-se për Janar, 2019.
- Raporti mbi obligimet financiare të kompanisë ndaj operatoreve ekonomik.

- Raporti mbi procedurat me përmbaruesit privat sipas njësive dhe inkasimet e deritanishme nga këto procedura si dhe te paraqiten borxhet sipas kategorive.
- Te na dërgohen fotokopjet gjendja e obligimeve nga ATK-ja.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit rekomandoj menaxhmentin e Kompanisë që obligimet me vlera te vogla ndaj operatorëve ekonomik të pastrohen.
- Komisioni i Auditimit kërkoj që në takimin e radhës të paraqitet gjendja se çka është ndërmarr lidhur me borxhin e Kompanisë ndaj Radoniqit dhe qendrës sportive Sezai Surroi.
- Komisioni i Auditimit rekomandoi që brenda shërbimit të financave të caktohen dy punonjës që të përcjellin gjendjen mujore të obligimeve të pa paguara për të gjithë konsumatorët.
- Të merret obligim nga financat që të bëhet raport për humbjet e bartura prej kur kanë fillu humbjet dhe si ka ardhur te 6mil. e 800mij pra të ndahen sipas viteve prej 2002-2018.
- Komisioni i Auditimit rekomandoj që Bordi të kërkoj nga ATK-ja të kontrolloi Kompaninë "Hidroregjioni Jugor" edhe në vitin 2018.
- Raporti vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2018 mbetet te diskutohet ne takimin e radhës së Komisionit të Auditimit.

3. Takimi i tretë i K.A është mbajtur me datë 25.03.2019, ku gjatë këtij takimi është shqyrtuar:

- Performanca operative e financiare shkurt 2019,
- Raportim nga Auditori i brendshëm,
- Të tjera

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë

- Komisioni i Auditimit aprovoi përformancën e Kompanisë për muajin shkurt 2019 me vërejtje të rritjes së shpenzimeve te tjera dhe shpenzimet e pagave.

Komisioni i Auditimit kërkoj nga njësia e Malishevës të punohet më tepër që mos të kemi mbulueshmëri operative me minus dhe te njësia e Dragashit të merren masa që disa punëtor të kësaj njësie të sistemohen ne Prizren ne menyre që të kemi pasqyre tjetër për këtë njësi punuese.

- Komisioni i Auditimit aprovoi raportin e punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2018, mbetet që rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm e që janë në proces të realizimit të implentohen nga njësitet përkatëse.
- Komisioni i Auditimit aprovoj raportin e auditimit lidhur me menaxhimin e pasurisë me vërejtje te e gjetura që është bërë realizim i projekteve jashtë planit vjetor të paraparë me plan biznes të kompanisë për vitin 2018 e që është i ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit për Komunën e Mamushës, që është në shumë prej rreth 213,022.56 euro.
- Komisioni i Auditimit aprovoi raportin e auditimit lidhur me menaxhimin e te hyrave, mbetet që të realizohen rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm.

- Komisioni i Auditimit rekomandoi Bordin e Drejtoreve që mos të aprovohet kjo rritje e koeficienteve për disa punonjës sepse nuk ka të bëjë me nivelizim të koeficienteve në nivel të Kompanisë.

4. Takimi i katërt i K.A është mbajtur me datë 27.05.2019, ku gjatë këtij takimi është shqyrtuar:

- Performanca operative e financiare, Prill 2019 dhe realizimi i caqeve për këtë periudhë,
- Prezantimi i deklaratës së ATK-s për vitin 2018,
- Prezantimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 nga zyra kombëtare e Auditimit
- Prezantimi i të gjitha ato që janë implementuar e të cilat kanë dal nga të gjeturat e Auditorit të brendshëm,
- Prezantimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit që kanë qenë të planifikuara për TM4 2018 dhe TM1 2019, si dhe
- Të tjera.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

-K.A paraqiti shqetësim lidhur me përformancën jo të mirë të njësisë së Dragashit duke potencuar se rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Auditimit që disa punëtor të kësaj njësie të sistemohen në Prizren në mënyrë që të kemi pasqyrë tjetër për këtë njësi punuese nuk është zbatuar prapë kërkoj që ky rekomandim të implementohet brenda një muaji nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar dhe lidhur me këtë të raportojnë në takimin e radhës së komisionit të Auditimit.

- Komisioni i Auditimit aprovoj draft raportin e auditimit nga ZKA me komentet e dhëna nga KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, Prizren.

Komisioni i Auditimit insiston që komentet e Kompanisë në të gjeturat e auditorit të jen pjesë përbërëse e raportit final të ZKA.

-Komisioni i Auditimit rekomandon menaxhmentin e Kompanisë që të trajtohen 4 rekomandimet të cilat nuk janë zbatu nga raporti i viti të kaluar dhe të merr masa për zbatim të të gjeturave tjera konform draft raportit të ZKA të vitit 2018.

- Komisioni i Auditimit njëzëri Aprovoj Raportin e TM1-2019 të Punës së Auditorit të Brendshëm, duke kërkuar nga departamentet dhe shërbimet përkatëse të Kompanisë të i adresojnë dhe implementojnë të gjeturat e Auditorit të Brendshëm.

- Pasi u prezantuan me anë të tabelave aktiviteteve të prokurimit të cilat janë planifikuar për TM1 2019, Kryesuesi i Komisionit të Auditimit kërkoj që në takimin e radhës të Bordit të Drejtoreve të raportoj Kryesuesi i Zyrës së prokurimit njëherit kërkoj nga Auditori i Brendshëm që të auditoj sa janë realizuar aktiviteteve të prokurimit që kanë qenë të planifikuara në TM4-2018.

5. Takimi i pestë i K.A është mbajtur me datë 26.07.2019, ku gjatë këtij takimi është shqyrtuar:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës,
- Performanca operative e financiare, Qershor 2019 dhe realizimi i caqeve për këtë periudhë,
- Te prezantohet rivlersimi i raportit të ATK-s për vitin 2018,
- Te prezantohen treguesit operativ e financiar për TM2.
- Realizimi i caqeve Janar-Qershor 2019,

- Të prezantohen te gjitha aktivitetet e prokurimit qe kanë qenë te planifikuara për TM4 2018, TM1 2019 dhe TM2 2019.
- Shqyrtimi i Raportit te Auditorit të Brendshëm për TM2-2019.
- Të tjera.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit rekomandon Menaxhmentin e Kompanise bashkë me Udhëheqësit e Njësive Punuese, ti shtojnë përpjekjet në mënyrë që të gjitha caqet e performances të dalin në operim pozitiv në muajt e ardhshëm.
- Komisioni i Auditimit jep vërejtje Menaxhmentit të Kompanisë për mos implementimin e rekomandimit të Komisionit të Auditimit për bartjen e disa punëtoreve nga Njësia Punuese e Dragashit në Njësinë e Prizrenit.
- Komisioni i Auditimit jep vërejtje Udhëheqësit të Njesisë Punuese të Malishevës për mosinformim të konsumatoreve të Malishevës për ndërprerjet e ujit për konsumatorët e Malishevës.
- Komisioni i Auditimit kërkoi nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit që në momentin që do të merr përgjigje nga ATK-ja lidhur me ankesën të informoj menjëherë Komisionin e Auditimit
- Komisioni i Auditimit rekomandon Menaxhmentin e Kompanisë që të shtohet angazhimi në rritjen e arkëtimit dhe zvogëlimin e shpenzimeve aty ku ka mundësi me qëllim që Kompania të operoj me performancë pozitive ne tremujoret e ardhshëm.
- Komisioni i Auditimit jep vërejtje të gjithë indikatorëve që kanë të bëjnë me realizimin e caqeve te planifikimit të Plan Biznesit.
- Komisioni i Auditimit rekomandon menaxhmentin e kompanise që te rrisin aktivitetet që në gjashtë mujorin e dytë te realizojnë caqet e Plan Biznesit.
- Komisioni i Auditimit aprovoi raportin e Auditorit të Brendshëm për TM2 2019.
- Komisioni i Auditorit Aprovoj Deklaratën për politiken e Kompanizimit për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarët e KRU”Hidroregjionit Jugor “sh.a dhe të njëjtën propozon të aprovoj edhe Bordi i Drejtorëve.

6. Takimi i gjashtë i K.A është mbajtur me datë 25.09.2019, ku gjatë këtij takimi është bërë:

- Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
- Shqyrtimi dhe aprovimi i rendit të ditës,
- Performanca operative e financiare,Korrik,Gusht 2019 dhe realizimi i caqeve për këtë periudhe,
- Të merret gjendja e obligimeve ne ATK, dhe te na dërgohet fotokopja.
- Të prezantohen te gjitha aktivitetet e prokurimit qe kanë qen te planifikuara për TM4 2018, TM1, TM2 2019 dhe deri me tani.
- Të na paraqitet gjendja e llogaris bankare e KRU nga te gjitha institucionet financiare.
- Të tjera.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

-Performanca në korrik , gusht paska qenë e mirë por faturimi i ujit nuk është i kënaqshëm ngase ka konsum më të madh të ujit gjatë verës.

-A.Z. raporti i përfomancës për korrik,gusht do te shqyrtohet edhe ne takim te Bordit te Drejtorëve i kompletuar me komente te shërbimeve përkatëse andaj varësisht nga arsyeshmërit e Kompanisë do te diskutojmë ne Bord.

- Komisioni i Auditimit vendosi që për gjendjen e borxhit të Kompanisë ndaj ATK-së të informohet me kohë Komisioni i Auditimit lidhur me përgjigjen e ATK-së ndaj ankesës së fundit të Kompanisë dhe si pikë do të shqyrtohet ne takimin e radhës së komisionit te auditimit.

- A.Zulfaj- tha se mos paraqitja e punonjësit përgjegjës të autorizuar nga Zyra e prokurimit për të raportuar aktivitetet e prokurimit në takim të Komisionit të Auditimit është papërgjegjësi e punës për të cilën japim vërejtje më shkrim nga komisioni i Auditimit dhe se këtë pikë e bartim për takim të Bordit të datës 27.09.2019.

-Komisioni i Auditimit për takim të Bordit kërkoj që tabela e prokurimit të plotësohet se kush ka aplikua kush e ka fituar tenderin dhe me çfarë vlere është fituar, kjo vlen për procedurat e përfunduara të projekteve në prokurim për prridhen e në fjalë.

- A.Zulfaj- kërkoj që për takim të Bordit të paraqitet rrjedhja e parasë në llogaritë rrjedhëse që janë më kryesore si p.sh pagesa e blerjes se veturës zyrtare, udhëtimit zyrtar në Tiran për trajnim elektronik apo digjital të prokurimit e te tjera që janë shuma më të mëdha nga 01.01.2019.

Lidhur me blerjen e veturës zyrtare të paraqitet raport sa është shpenzimi për blerjen e veturës zyrtare , prej cilës llogari është bërë pagesa, te kush është bërë pagesa, kur është hapur tenderi, si është zgjedh Kompania fituese pra në raport të përfshihen të gjitha procedurat nga fillimi deri te pagesat.

-Po ashtu kërkoj raport për arsyeshmërinë e shpenzimeve lidhur me ekskursionin e bërë ne Shqipëri me arsyetim për trajnim elektronik apo digjital te prokurimit, ne raport te përfshihen shpenzimet, te arriturat, synimet e këtij trajnimi.

7. Takimi i shtatë i K.A është mbajtur me datë 23.10.2019, ku gjatë këtij takimi është shqyrtuar:

-Performanca operative e financiare,Shtator 2019 dhe realizimi i caqeve,

-Raporti mbi treguesit operativ Janar- Shtator 2019 dhe realizimi i caqeve te planifikuara.

-Shqyrtimi i draftit te Planit te biznesit 2020-2022 te KRU, si dhe

-Të tjera.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit propozoi që raporti të diskutohet në mënyrë më të detajuar në takimin e Bordit të Drejtorëve,

- Është diskutuar rasti se pse në Malishevë investimet nuk po shkojnë më tutje por kanë ngecur? Gjithashtu kërkoi të informohet për Lagjen e lartë të Senikut, pasi në këtë lagje nuk ka gyp të veçantë?

8. Takimi i tetë dhe i fundit për vitin 2019, i K.A është mbajtur me datë 26.11.2019, ku gjatë këtij takimi është shqyrtuar:

-Performanca operative e financiare,Tetor 2019 dhe realizimi i caqeve.

- Raporti mbi treguesit operativ Janar - Tetor 2019 dhe realizimi i caqeve te planifikuara.
- Shqyrtimi i raportit për lendet qe janë proceduar tek përmbaruesit privat ne te tri kategoritë për periudhën Janar-Tetor 2019.
- Te tjera.

Konkluzionet dhe vendimet e marra të K.A gjatë këtij takimi kanë qenë:

- Komisioni i Auditimit kërkoi nga njësia e Suharekës, Malishevës dhe Dragashit të shtojnë përpjekjet që të ngritët norma e arkëtimit te kategoritë e konsumatorëve që të jet në përputhje me caqet e planifikuara nga menaxhmenti i Kompanisë dhe Bordi i Drejtorëve.
- Komisioni i Auditimit kërkoi që nga shërbimi për konsumator që raporti të plotësohet duke ndarë konsumatorët e dërguar te përmbaruesi sipas kategorive bashkë me vlerën e borxhit si dhe te paraqitet ne takimin radhës së Bordit.

2.2 Informacionet lidhur me kapitalin dhe difidenten

Kampania nuk ka rritje të kapitalit

2.3 Kredit e rëndësishme të nënshkuara apo paguara gjatë vitit 2019

Kredit afatshkurta nga viti 2018 e të bartura në vitin 2019 janë 30.000,00€

Kredi në vitin 2019 – 15.000,00€

Kredi te paguara ne vitin 2019 – 18.029,00 €

2.4 Investimet gjatë vitit 2019

KRU ..HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

INVESTIMET - JANAR-DHJETOR 2019		
1	INVESTIMET VETANAKE	662,507.34 €
2	INVESTIMET- K.K -MALISHEVË	8,573.34 €
3	INVESTIMET- K.K -MAMUSHË	9694.94
4	INVESTIMET- K.K -PRIZREN	83707.64
5	TOTAL	764,483.26 €

P.S: Me poshtë janë te presantuara investimet ne detaje

2.5 Dividentat e paguara gjatë vitit

Nuk ka pasë pagesa ne emër te dividendes

3. RAPORTI I ZYRTARIT KRYESOR EKZEKUTIV

3.1 NGJARJET KRYESORE TË VITIT

3.1.1 AKTIVITETET MGA SHËRBIMI TEKNIK

3.1.2 SITUATA E FURNIZIMIT – JANAR – DHJETOR 2019

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë. Kompania ka arritur që në muajt Janar-Dhjetor të vitit 2019 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në dite. Sa i përket pjesës së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, lagjen Dardania, lagja 2 Korriku që nga muaji Qershor janë eliminuar komplet reduktimet dhe këto lagje kanë furnizim të rregullt me ujë të pijes. Në muajt Korrik dhe Gusht kemi aplikuar reduktime në fshatrat e komunës së Prizrenit. Për me gjerësisht është prezentë tabela e reduktimeve nga njësia Operuese në Prizren të cilën munde ta gjeni në webfaqen e kompanisë.

Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes mirëpo duke u bazuar në raportet e njësive operuese kemi aplikuar reduktime të planifikuara në varësi të defekteve të mundshme si dhe ndërprerjeve të energjise elektrike nga KEDS (për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njësive Operative nga udhëheqësit e Njësive).

3.1.3 AKTIVITETET KRYESORE

- * Takime të mëngjesit me Kryeshefin Ekzekutiv
- * Takim në Gjonaj - 10:00 (Me kërkesë të banorëve afër bazenit të Gura).
- * Takim me Joerg (Konsulenca).
- * Vizitë tek lumi në Prevallë - për mundësinë e kthimit të ujit në drejtim të 40 Burimeve.
- * Takim i Menaxhmentit.
- * Takim në Ministrinë e Ambientit – Prishtinë.
- * Takim me ARRU - Prishtinë.
- * Takim me Drejtorin e Shërbimeve Publike Levent Kasemi – Prizren.
- * Takim me Bordit.
- * Takim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik - Për Fazën VI.
- * Takim me Joerg-in (Konsulenca) Dorsch Group.
- * Takim me Konsulencën - p2m.
- * Takime të rregullta javore në Impiant.

- * Takim me p2m dhe Dorsch.
 - * Takim me ASECO.
 - * Takim me MZHE për Fazën V dhe VI.
 - * Takim në Gjakovë - Asociacioni i Komunave.
 - * Takim në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Kuvendi Komunal – Prizren.
 - * Takim i vecant me Konsulencën - p2m.dhe me kontrfaktorin.
 - * Dergimi i marrevshjes se vecant per fazen VI- sistemi i ujerfave te zeza ne qytetin e Prizrenit.
 - * Korrespondencat me Ministrine e Finacave ne lidhje me rimbursimin e TVSH-se per projektin e ujerave te zeza-dergimi i marrveshjeve financiare dhe marrevshjes se vaacant.
 - * Formimi i grupeve per menjanimin e faturimit paushall, me posht i gjeni aktivitetet dhe ekziston raport i vecant i ecurise se punimeve.
 - * Revidimi i Planit te Biznesit te Kompanise, ku jane riplanifikuar investimet per vitin 2019 dhe vitet ne vijim,(2019-2022).
 - * Dergimi i te dhenave per ujra te zeza ne UNDP “Mbështetje për një Prizren të Qëndrueshëm.
 - * Korrespondencat per Fazen v te projektit CCTV, dokumentcioni i tenderit dhe komplet projekti per fazen V dhe VI i eshte dorezuar Aranit Ukimeri, i cili se bashku me ekipen e sherbimit teknik do ta menaxhoj kete projekt.
 - * Pergaditja e shtojces nr,3 per investimet kapitale te cilat do te vihen ne planin e biznesit.
 - * Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe projektit të Eficiences së Energjisë Elektrike të financuar nga KfW, raportet perkatese janë proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.
 - * Sa i përket projektit te Ujerave te Zeza, konkretisht Fazes 1 dhe Fazes 2 te projektit, ju njoftoj se Faza 1 e projektit që ka të bëjë me Ndërtimin e kolektorit në anen e majtë të Lumbardhit, ka përfunduar komplet, tani jemi në fazën e përgaditjes përfundimtare të dokumentacionit të cilin do ta dorezojmë në arkive dhe në shërbimin për kontabilitet në menyre që të regjistrohet si aset i Kompanisë, kurse sa i përket Fazës 2 të projektit, tani me kemi hyre në fazën përfundimtare dhe sipas planit dinamik të rishikuar, punimet do të përfundojnë në dhjetor të vitit 2019.
- Për më tepër kemi në dispozicion Raportet Mujore dhe Tremujore si dhe për çdo gjë tjetër munde ta kontaktoni Kryetarin e Komitetit të këtij projekti Lulzim Paçarizi dhe Anetarin e këtij komiteti Lumni Sallahun (nuk ka ndonje ndryshim te theksuar ne lidhje me progresin e punimeve per Fazen 2).

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2018

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1,910	771	2,681
Suharekë	380	173	553
Dragash	60	25	85
Malishevë	569	171	740
Total	2,919	1,140	4,059

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Janar-Dhjetor, 2019

Njësia Operative	Ujësjetësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	1,584	616	2200
Pra si përfundim, shpenzimet për këtë vit, kanë qenë më të larta në krahasim me vitin 2018, për arsyet e cekura më lartë, pra pozicioni i pagave, i energjisë elektrike dhe i mirëmbajtjes së automjeteve ka qenë më i lartë, për arsyet e cekura më lartë.

3.8.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Duke e pare gjendjen financiare ne KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para tri rreziqeve relativisht te mëdha:

1. Vendimi i ATK nr. 332/2019 dat.28.08.2019 lidhur me pagimin e borxhit ndaj ATK dhe atë :

Mos pagimi i TVSH sipas ATK pas përfundimit te marrëveshjes mes KRU HIDROREGJIONI JUGOR SH.A dhe ATK me date 10.06.2015 Shuma e borxhit është

291.274,94 , ndëshkimet dhe interesi ne shume prej 201.078,36. Gjithsejt borxhi **493.353.30 €**

2. Mos aplikimi i TVSH me ngarkesë te kundërt nga ana e kompanisë ,nuk është njohtë TVSH e zbritshëm ne Shume prej – **315.778,19 €** . Kjo shume Kompania duhet ta ndaj ne konto te veçanta e cila shume duhet te investohet ne ITUZ.
Hapat e ndërmarra: Ankesa ne vendimin e ATK pran Avokatit për Tatimpagues, si dhe Ankesa ne Divizionin Fiskal te Departamentit Administrativ ne Gjykatën Themelore ne Prishtine.
3. Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borxhin e Kompanisë ndaj KEK .ne shume prej : **1.489.264,96 €**
Hapat e ndërmarra: Prapësimi i vendimit ne Gjykatën e apelit.

3.8.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE


3.8.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

3.9 PERFORMANCAT FINANCIARE – SHPENZIMET €

3.9.1 SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN
2016-2019

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	2016	2017	2018	2019
1	Total Shpenzimet Operative	3,411,977.42	3,558,868.84	3,638,837.12	3,977,437.60
2	Pagat	1,860,957.71	1,995,391.18	2,070,016.29	2,334,028.10
3	Rryma elektrike	854,176.83	893,939.67	851,608.07	925,486.70
4	Shpen. e derivateve	65,895.33	71,556.89	85,875.30	90,439.67
5	Mirem. dhe riparimet	312,774.13	198,508.42	262,875.84	262,773.60
6	Mirem. e automjeteve		43,921.49	49,898.29	63,662.59
7	Shpen.e taksave		96,998.00	87,979.25	98,145.69
8	Kemikaliet	12,607.13	9,837.10	12,997.04	9,969.00
9	Shpenzimet e tjera	305,566.29	248,716.09	217,587.04	192,932.25
2	Ndryshimi		146,891.42	79,968.28	338,600.48
3	Ndryshimi ne %		4.31%	2.25%	9.31%



3.9.2 SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN

TM1-TM2-TM3-TM4 -2019

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	TM1- 2019	TM2- 2019	TM3- 2019	TM4- 2019
1	Total Shpenzimet Operative	964,465.14	958,832.62	1,000,342.68	1,053,797.16
2	Pagat	560,048.82	574,648	584,032	615,300
3	Rryma elektrike	228,736.87	226,000	241,011	229,739
4	Shpen. e derivateve	21,582.28	18,987	23,566	26,305
5	Mirem. dhe riparimet	49,741.73	65,363	62,548	85,121
6	Mirem. e automjeteve	13,306.31	15,164	14,346	20,846
7	Shpen.e taksave	27,645.44	26,538	20,728	23,235
8	Kemikaliet	2,412.53	1,628	3,564	2,365
9	Shpenzimet e tjera	60,991.16	30,506	50,548	50,887
2	Ndryshimi		(5,632.52)	41,510.06	53,454.48
3	Ndryshimi ne %		-0.58%	4.33%	5.34%

3.9.3 SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN

GJM1-GJM2 -2019

SHPENZIMET - €			
No.	Të dhënat	GJM1- 2019	GJM2- 2019
1	Total Shpenzimet Operative	1,923,297.76	2,054,139.84
2	Pagat	1,134,696.51	1,199,331.59
3	Rryma elektrike	454,736.82	470,749.88
4	Shpen. e derivateve	40,569.53	49,870.14
5	Mirem. dhe riparimet	115,104.44	147,669.16
6	Mirem. e automjeteve	28,470.27	35,192.32
7	Shpen.e taksave	54,183.37	43,962.32
8	Kemikaliet	4,040.06	5,928.94
9	Shpenzimet e tjera	91,496.76	101,435.49
2	<i>Ndryshimi</i>		130,842.08
3	<i>Ndryshimi ne %</i>		6.80%

3.9.4 SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN
CAQET - PB -2019

HPENZIMET - €						
No.	Të dhënat	JAN-DHJET - 2019	JAN-DHJET - 2019 (PB)	(PB - PA ITUZ)	Ndryshimi	Ndryshimi ne %
1	Total Shpenzimet Operative	3,977,437.60	4,135,447.13	3,779,171.13	198,266.47	5.25%
2	Pagat	2,334,028.10	2,333,000.00	2,222,729.00	111,299.10	5.01%
3	Rryma elektrike	925,486.70	980,500.00	889,532.00	35,954.70	4.04%
4	Shpen. e derivateve	90,439.67	80,918.66	79,918.66	10,521.01	13.16%
5	Mirem. dhe riparimet	262,773.60	334,942.54	263,861.54	(1,087.94)	-0.41%
6	Mirem. e automjeteve	63,662.59	44,492.84	42,492.84	21,169.75	49.82%
7	Shpen.e taksave	98,145.69	88,018.04	88,018.04	10,127.65	11.51%
8	Kemikaliet	9,969.00	26,486.21	11,293.21	(1,324.21)	-11.73%
9	Shpenzimet e tjera	192,932.25	247,088.84	181,325.84	11,606.41	6.40%
2	Ndryshimi		(158,009.53)	198,266.47		
3	Ndryshimi ne %		-3.82%	5.25%		

4. PERSONELI

4.1 PERSONELI - JANAR - DHJETOR 2016-2019

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A – PRIZREN

	VITI	2016	2017	2018	2019
	N.PUNESE				
1	PRIZREN	231	238	235	242
2	SUHAREKË	37	38	37	37
3	DRAGASH	16	17	16	17
4	MALISHEVË	35	34	36	36
5	HIDROREGJIONI	319	327	324	332
6	NFRYSHIMI		8	-3	8
7	NDRSHI. - %		2.5%	-0.9%	2.5%

4.2 PERSONELI (CAQET – PB- 2019)

JANAR-DHJETOR - 2019

KRU „HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A - PRIZREN

v	VITI	2019	2019 (PB)
	N.PUNESE		
1	PRIZREN	242	241
2	SUHAREKË	37	38
3	DRAGASH	17	16
4	MALISHEVË	36	35
5	HIDROREGJIONI	332	330
6	NFRYSHIMI		2
7	NDRSHI. - %		0.6%

5. TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

5.1 JANAR-DHJETOR - 2019

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“
SH.A - PRIZREN

Treguesit e Performancës	[Njesia]	2019												
		JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QER	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	JANAR-DHJETOR 2019
Uje i faturuar-si perqindje	%	43.8%	43.8%	43.8%	43.9%	46.7%	44.1%	44.2%	44.4%	44.3%	44.3%	44.4%	44.30	44.1%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	56.2%	56.2%	56.2%	56.1%	53.3%	55.9%	55.8%	55.6%	55.7%	55.7%	55.6%	55.70	55.9%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	95.40	105.17	97.93	80.79	81.63	67.60	94.38	86.36	86.39	118.83	105.52	134.58	94.92
Norma e arketimit - Amviserite	%	103.67	98.03	99.86	75.53	83.41	69.37	93.00	94.52	94.94	111.10	100.48	129.59	95.19
Norma e arketimit - Komercial-Industrial	%	96.49	120.83	102.88	72.09	61.01	63.92	76.57	64.91	84.98	117.28	109.19	109.79	88.08
Norma e arketimit - Institucional	%	37.66	129.42	80.28	119.91	101.27	60.57	134.83	60.42	39.01	169.62	128.21	208.91	103.05
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.14	1.22	1.03	0.97	1.05	0.89	1.24	1.37	1.16	1.29	1.21	1.17	1.15
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.66	6.67	6.70	6.68	6.67	6.65	6.50	6.56	6.44	6.44	6.27	6.33	6.55

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

5.2. K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN
2015- 2019

Treguesit e Performancës		JANAR- DHJETOR 2015	JANAR- DHJETOR 2016	JANAR- DHJETOR 2017	JANAR- DHJETOR 2018	JANAR- DHJETOR 2019
Uje i faturuar-si perqindje	%	42.17	42.27	42.14	43.10	44.10
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	57.83	57.73	57.86	56.90	56.90
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	71.97	87.20	94.62	95.70	94.92
Norma e arketimit - Amviserite	%	69.79	88.12	98.47	95.76	95.19
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	64.14	64.21	68.79	89.45	88.08
Norma e arketimit -Institucional	%	98.01	117.84	108.43	104.59	103.05
Norma e Mbulimit operativ	numer	0.95	1.12	1.13	1.14	1.15
Staf per 1000 konsumatore	numer	7.12	7.17	7.04	6.83	6.55

TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS

5.3. PERFORMANCAT - K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1-TM2-TM3-TM4- 2019

Treguesit e Performancës		TM1-2019	TM2-2019	TM3- 2019	TM4- 2019
Uje i faturuar-si perqindje	%	38.07	42.17	42.27	42.14
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	61.93	57.83	57.73	57.86
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	61.89	71.97	87.20	94.62
Norma e arketimit - Amviserite	%	58.48	69.79	88.12	98.47
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	47.60	64.14	64.21	68.79
Norma e arketimit -Institucional	%	99.29	98.01	117.84	108.43
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.00	0.95	1.12	1.13
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.54	7.12	7.17	7.04

5.4. PERFORMANCAT - K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

GJM1-GJM2 - 2019

Treguesit e Performancës		GJM1-2019	GJM2-2019
Uje i faturuar-si perqindje	%	38.07	42.17
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	61.93	57.83
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	61.89	71.97
Norma e arketimit - Amviserite	%	58.48	69.79
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	47.60	64.14
Norma e arketimit -Institucional	%	99.29	98.01
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.00	0.95
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.54	7.12

5.5. PERFORMANCAT - K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

JANAR-DHJETOR - (CAQET- PB)- 2019

Treguesit e Performancës		JAN-DHJET -2019	JAN-DHJET -2019 (PB)	DALLIMI
Uje i faturuar-si perqindje	%	44.10%	46.38%	-2.3%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	55.90%	53.62%	2.3%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	94.92	88.94	5.98
Norma e arketimit - Amviserite	%	95.19	85.00	10.19
Norma e arketimit -Komerical-Industrial	%	88.08	100.00	-11.92
Norma e arketimit -Institucional	%	103.05	100.00	3.05
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.15	1.19	-0.04
Staf per 1000 konsumatore	numer	6.55	7.12	-0.57

Treguesit e Performancës	[Njesia]	JAN-DHJET -2019	JAN-DHJET -2019 (PB)	DALLIMI	%
Te hyrat	€	4,560,581.02 €	4,713,469.00 €	- 152,887.98 €	-3.35%
Shpenzimet	€	3,977,437.60 €	3,952,342.00 €	25,095.60 €	0.63%
Mbulimi operativ	€	583,143.42	761,127.00 €	- 177,983.58 €	-30.52%
Keshi	%	1.15	1.19	-0.05	-4.01%

6. RAPORT NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i administratës gjatë këtij viti është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Në kuadër të raportit të Departamentit Administrativ sipas strukturës organizative të Kompanisë janë përfshirë edhe raportet e sektorëve të departamentit të administratës si raporti i punës së zyrës ligjore, i resurseve njerëzore, zyrtarit për siguri dhe shëndet në punë, aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës dhe raporti i punës së zyrës së teknologjisë informative për janar - dhjetor 2018.

- Gjatë këtij viti janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren . Për Vendimet dhe Rekomandimet e dala në takimet e BtD dhe Komisionit të Auditimit janë njoftuar të gjithë zyrtarët dhe udhëheqësit e Kompanisë pas përfundimit të procesverbalit të takimit përkatës.
- Nga zyra ligjore gjatë vitit 2018 është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Dragashit, Malishevës dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.
- Janë harmonizuar kontratat e punës së punëtorëve të Kompanisë sipas Vendimit për rritjen e vlerës së koeficientit nga 75 euro në 85 euro për të gjithë të punësuarit në KRU "Hidroregjioni Jugor" si dhe Vendimit për civilizimin i koeficienteve të një kategorie të punonjësve në Kompani.
- Gjatë vitit 2019 janë përgatitur dhe vazhduar kontratat e punës që kanë qenë në kohë të caktuar për punëtorët e Kompanisë. Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar në raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës, raporti i vlerësimit i bërë nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë I punëtorit.
- Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë vitit 2019.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimit apo pëlqimit nga udhëheqësit e tyre.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2019 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servisin e bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2019 gjerë më 15.01.2020 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit

qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpiloj raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzoj Kryeshefit Ekzekutiv gjatë më 20.01.2020.

- Në mbështetje të nenit 56 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212 , për punonjësit e Kompanisë është bërë kompensimi i punës jashtë orarit me ditë pushimi dhe përqindje te pagesës sipas ligjit ne fjalë.
- Në bazë të Nenit 59, Paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 dhe të nenit 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë, të punësuarit **B. K** i sistemuar me punë dhe detyra të punës Teknik laborant i kimisë-kujdestar në njësinë e Dragashit, i është lejuar shfrytëzimi i pushim mjekësor si pasoj e lëndimit në punë me kompensim prej 70% të pagës së tij.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendeve të punës me pëlqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Gjatë vitit 2019 janë pensionuar 4 (katër) punëtor K.R.U. "Hidroregjioni jugor" Sh.A Prizren, janë përgaditur dokumentet përcjellëse duke i bazuar ne Ligjin e punës.
- Është bërë ndërprerje e kontratës së punës punëtorit F.TH –Inspektor- Kontrollor , nga data 05.03.2019 për shkak te mos lajmërimit dhe mungesës në punë më tepër se 5 ditë pune pandërprerë, edhe përkundër përpjekjeve nga Udhëheqësi i njësisë së Malishevës të kontaktoj me telefon punonjësi në fjalë nuk është përgjigjur dhe se nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë. Duke mos i arsyetuar ditët e mungesës nga puna punëmarrësi sipas Rregullores mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të K.R.U. "Hidroregjioni Jugor"Sh.A në Prizren, neni 5 paragrafi 22 sjelljen e tillë të punëmarrësit e parasheh si shkelje të rëndë të detyrave të punës.
- Në mbështetje të nenin 38 paragrafi 2. të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, disa punonjësve të Kompanisë është bërë kompensimi i pushimit vjetor për vitin 2018 në lartësi të ardhurave personale të realizuara në muajin e fundit, sepse mos shfrytëzimi i pushimit vjetor është ardhur për arsye se nuk ka qenë e mundur të bëhet zëvendësimi i punëtorit në këtë vend të punës me punëtorët të tjerë të Kompanisë.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat mbi qiranë për lokacionet e hapjes së porto-arkave te reja në njësinë e Prizrenit dhe te Suharekës si dhe Marrëveshje në mes të kompanisë dhe palëve të treta në lëmim e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjatë vitit 2019 kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor 85 punëtorë të Kompanisë.
- Në Departament te administratës kemi pasur auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit për gjashtë mujorin e parë të këtij viti , dokumentet e kërkuara gjatë auditimit janë nga fusha e zyrës ligjore, dosjet e punëtorëve dhe te punësuarve te rinj, dokumentet e Bordit të drejtoreve qe përfshinte Vendimin e Emërimit dhe shkresën e NJPMNP për vazhdim të mandatit, Kodin e etikës, procesverbalet dhe vendimet e Bordit, procesverbalet e menaxhmentit të Kompanisë , ndryshimet ne staf gjatë vitit, rregulloret e Kompanisë për vitin 2019 etj.
- Është bërë mbikëqyrje dhe mirëmbajtje e duhur në azhurnimin e rregullt të ueb-faqes, siç parashihet me Ligj mbi NP, janë kryer të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetin përkatës sipas ligjit.

- Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik të punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njëjësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Sipas kërkesave menaxherëve të Kompanisë dhe të udhëheqësve të njëjësive punuese Prizren, Suharekë dhe Malishevë dhe pas aprovimit nga Zyrtar Kryesor Financiar("ZKF") dhe Kryeshefi Ekzekutiv në shtypin ditor janë shpallur **13** konkurse. Prej këtyre konkurseve shtatë janë anuluar, dhe katër konkurse janë rishpallur, nga këto konkurse janë punësuar (16) gjashtëmbëdhjetë punëtorë sipas konkurseve të shpallura gjatë vitit.

Nr	Pozita e punes	Nr i k	Dita e shpalljes se konkursit	Njesija	
1	Përgjegjës i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit	1	16.01.2019	MALISHEVE	
2	Rojtar	1	17.01.2019	DRAGASH	
3	Vozites I mjeteve (MLT)- Rojtar	1	17.01.3019	DRAGASH	
4	Inkasant	1	31.01.2019	PRIZREN	Anuluar me 01.03.2019
5	Rishpallje Inkasant	1	08.03.2019	PRIZREN	
6	Punëtor fizik ITUZ	3	29.03.2019	PRIZREN	Anuluar me 26.04.2019
7	Teknik i/e Labororit ITUZ	1	29.03.2019	PRIZREN	Anuluar me 03.05.2019
8	Porto-arkatar/e	2	11.04.2019	PRIZREN	
9	Porto-arkatar/e konkurs I brendshem	4	11.04.2019	PRIZREN	Anuluar 20.05.2019
10	Rishpallje Punëtor fizik ITUZ	3	14.05.2019	PRIZREN	Anuluar me 25.06.2019
11	Rishpallje Teknik i/e Labororit ITUZ	1	14.05.2019	PRIZREN	Anuluar me 26.06.2019
12	Rishpallje Punëtor fizik ITUZ	3	03.07.2019	PRIZREN	
13	Rishpallje Teknik i/e Labororit ITUZ	1	03.07.2019	PRIZREN	
14	Koordinator në sektorin e operatives dhe mirëmbajtje	1	12.07.2019	SUHAREKE	
15	Vozitës me kategori C		12.07.2019	MALISHEVE	
16	Porto-arkatar/e	4	14.08.2019	PZ 3--SU --1	
17	Rishpallje Porto-arkatar/e	2	10.10.2019	PZ-1 - SU -1	Anuluar 22.11.2019
18	Teknik i/e Labororit ITUZ	1	22.11.2019	PRIZREN	
19	Asistrent i labororit ITUZ	1	22.11.2019	PRIZREN	

- Është përgatitur Libri lidhës për Qeverisjen Korporatave për vitin 2018 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : Certifikatën e regjistrimit të Biznesit,Vendimin mbi emërimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për vitin 2018, Vendimet e Bordit për 2018, Procesverbalet e Komisionit të Auditimit, Deklarata e politikës së kompensimit,Vendimet mbi themelimin e komiteteve tjera të Bordit, Procesverbalet e komiteteve, Plan-Biznesi 2018-2019 dhe raporti vjetor 2018.
- Përgatitja e Aktvendimeve për pushim pa pagesë për disa punëtor të Kompanisë pas aprovimit të kërkesës së tyre nga udhëheqësi i shërbimit përkatës.
- Përgatitja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve,autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Gjatë viti 2019 kanë ndërprerë marrëdhënien e punës me vet dëshirë 7 punëtor të Kompanisë dhe 2 punëtor kanë vdekur.
- Është dërguar në NJPMNP sipas kërkesë Lista me të dhënat e kohëzgjatjes së kontratave të punës për zyrtarët e lartë të kompanisë.
- Pas kërkesës për vazhdim të bashkëpunimit në projektin e punësimit të rinjve të bërë nga Kompania jonë, është nënshkruar Marrëveshje e bashkëpunimit për praktikë në

punë të punëkërkuarve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe KRU "Hidroregjioni Jugor". Marrëveshja do të fillojë së zbatuari me datë 01 gusht dhe do të zgjasë deri me 31 janar 2020. MPMS punëtorët e angazhuar do të paguaj me pagë mujore në shumën prej 250 euro në muaj dhe KRU "HRJ" do të bashkë financoi projektin duke siguruar mjetet e punës për punëtor si dhe shujtat ditore në vlerë prej 2.5 euro në ditë.

- Sipas kërkesës së Drejtorisë së shërbimeve publike të Komunës së Prizrenit i është dërguar raport që përfshinë numrin e punëtorëve për vitin 2018 sipas nacionalitetit, gjinisë, njësive punuese si dhe numrin e punonjësve më aftësi të kufizuar.
- Në MZHE janë dërguar dokumentet e kërkuara për kompletim të ueb faqes së MZHE për vitin 2017. Dokumentet e dërguara në formë elektronike, të skanuara, të nënshkruara dhe të vërtetuara me vulën e Kompanisë janë: Struktura Organizative – Organogrami 2017, Pagat e zyrtareve të lartë për vitin 2017, lista me 10 furnizuesit më të mëdhenj për nga vlera për vitin 2017, Te gjitha Kontratat e Prokurimit me vlera të mëdha për vitin 2017, të gjitha Rregulloret e miratuara nga Bordi i Drejtorëve për vitin 2017, të gjitha dokumentet me rendësi të miratuara nga BD për vitin 2017 si dhe Konfirmim nga Kryesuesi i BD se nuk ka Konflikt të Interesit tek anëtarët tjerë të BD.
- Është dërguar në NJPMNP-MZHE lista e punonjësve të Kompanisë duke përfshirë pozitën e punës, koeficientin dhe pagën e punonjësve për vitin 2019 dhe tabelori me emrat e zyrtarëve të lartë të Kompanisë, datën e emërimit dhe kohëzgjatjen e kontratës së punës.
- Me kërkesë të NJPMNP i është dërguar raport lidhur me numrin e punëtorëve në Kompani për periudhën kohore janar-mars 2019.
- Sipas kërkesës së tyre në NJPMNP janë dërguar të dhënat për numrin e punëtorëve aktual në Kompani (vitin 2019), projektet kapitale që janë duke u zhvilluar dhe prioritetet e ndërmarrjes për këtë vit dhe vitet në vijim. Po ashtu i janë dërguar raporti i ZKA-2018, raporti vjetor i Kompanisë për vitin 2018, procesverbalet e Bordit dhe Komisionit të Auditimit për vitin 2019.
- Me kërkesë të Menaxherit rajonal për konsumator dhe arsyetimin e nevojave të shërbimit për konsumatore ka pas ndërrim të pozitave të punës: nga pozita e punës Inkasant në Inspektor/kontrollor kanë kaluar pesë punëtorë nga pozita e punës Inkasant në Porto-arkëtar tre punëtorë
- Me Aktgjykim të Gjykatës së Apelit është kthyer në punë punonjësi R.Hoxha
- Ndryshim të pozitës së punës për dy punëtor nga pozita e punës Inspektor /kontrollor në

Udhëheqës për inspektorat/kontroll të njësive punuese Suhareke dhe Malisheve, ka dhe

ndryshim koeficienti nga 5 në 5.5- A. Hoti – Malisheve dhe Sh. Canaj – Suharekë.

PERSONELI – JANAR– DHJETOR 2019

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Punë praktike
Janar	327		3		
Shkurt	327				
Mars	329	2		1	

Prill	329		2		
Maj	330	1		1	
Qershorr	330			1	

Korrik	328	2			
Gusht	327		1		8
Shtator	332	1			8

Tetor	334	2	2		8
Nentor	333		1	1	8
Dhjetor	332				8

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2019

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A							
DHJETOR	KUALIFIKIMI						
	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejtë
Nr. i punëtorëve	36	45	1	206	43	1	332
Kualifikimi në %	10.84	13.55	0.30	62.05	12.95	0.30	100

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2019

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	287	34	4	7	332
Numri i Punëtorëve në %	86,4	10,2	1,2	2,1	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	43	12,95	
MESHKUJ:	289	87,05	
TOTAL	332	100,00	

Raport i numrit te punetoreve Janar - Dhjetor, 2019

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren			Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Total			
1	Janar	333	238	6	244	37	16	36
2	Shkurt	333	238	6	244	37	16	36
3	Mars	335	238	6	244	37	18	36
4	Prill	335	238	6	244	37	18	36
5	Maj	336	239	6	245	37	18	36
6	Qershor	336	240	6	246	36	18	36
7	Korrik	334	240	6	246	36	17	35
8	Gusht	333	239	6	245	36	17	35
9	Shtator	338	242	6	248	37	17	36
10	Tetor	340	244	6	250	37	17	36
11	Nentor	339	243	6	249	37	17	36
12	Dhjetor	338	242	6	248	37	17	36

Çdo kërkesë për punonjës të ri në Kompani është bazuar në planifikimet dhe kërkesat me arsyeshmëri të Menaxherëve të Departamenteve dhe udhëheqësve të njësive operative të Prizrenit ,Suharekës,Malishevës dhe Dragashit.

Arsyeshmëria e punësimit të punonjësve të ri gjatë vitit 2019 është me qëllim që të kemi menaxhim dhe një mbikëqyrje e punimeve në nivel profesional ne zona te reja te shërbimit. Numri i punëtorëve është planifikuar duke u marrë parasysh: formimi ekepeve të veçanta për mirëmbajtjen dhe analizën e sistemit ekzistues të kanalizimit-Ujerve të zeza në qytetin e Prizrenit, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në zonat rurale sipas projektit të zyrës Zvicerane, rritja e numrit të konsumatorëve si dhe duke u bazuar në rritjen e aktiviteteve dhe efikasitetin të punës në Kompani.

Gjatë planifikimit të vendeve të punës dhe themelimit të marrëdhënies së punës është respektuar Ligji i Punës, Ligji i Ndërmarrjeve Publike dhe Kodi i Etikës dhe se Kompania nuk bënë asnjë dallim apo diskriminim në organizimin apo caktimin e obligimeve të punës në të gjitha shërbimet.

6.2 PËRFAQËSIMI NË GJKATA DHE ARDHJA TOTALE E LËNDËVE NGA GJKATAT PËR PERIUdhËN KOHORE JANAR – DHJETOR 2019 SEANCAT GJYQËSORE

Muaji	Seanca përgatit ore	Seanca kryesor e	Seanca të shtyra	Shkresa të ardhura nga gjykatat
Janar	/	1	/	21
Shkurt	1	1	/	25
Mars	4	/	/	11
Prill	1	/	/	17
Maj	1	/	3	15
Qershor	1	/	1	15
Korrik	1	/	3	44
Gusht	1	1	2	20
Shtator	1	5	2	28
Tetor	2	2	4	28
Nëntor	2	1	3	25
Dhjetor	1	2	3	21
Totali	16	13	21	270

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **50 (pesëdhjetë)** seanca gjyqësore prej të cilave **16 (gjashtëmbëdhjetë)** seanca kanë qenë përgatitore, **13 (trembëdhjetë)** seanca kryesore, dhe, **21 (njëzetë e një)** seanca gjyqësore për arsye objektive janë shtyrë dhe do të caktohen data tjera për shqyrtim.

Gjatë vitit 2019 nga gjykatat në kompani kanë ardhur **270 (dyqindtë e shtatëdhjetë)** shkresa.

Gjatë tremujorit të katërt (**TM4**) të vitit 2019, në Zyrën Ligjore nga Gjykatat në total në Kompani janë sjellë **74 (shtatëdhjetë e katër)** shkresa të cilat janë të pasqyruara në këtë tabelë:

JANAR- DHJETOR - 2019	TM 1	TM 2	TM 3	TM 4
Aktgjykime në favor të Kompanisë	2	/	/	/
Aktgjykime kundër Kompanisë	/	/	/	2
Aktvendime në favor të Kompanisë	7	7	12	14
Aktvendime kundër Kompanisë	4	5	25	12
Aprovime të pjesrishme me Aktvendime nga Gjykata	20	8	27	26
Aktvendime për shkak të vdekjes së konsumatorëve	/	1	/	/
Konkluzione të ndryshme	8	1	4	/
Aktvendime për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm	3	10	2	3
Konkluzione për njoftim të gjykatës nga ana e Kompanisë	/	/	/	/
Njoftime dhe Kërkesa nga Gjykata dhe Institucione tjera	/	2	/	1
Thirrje për seanca gjyqësore	5	9	17	5
Padi	/	/	/	/
Përgjigje në Padi	/	/	/	/
Ankesë në Gjykatën e Apelit	4	1	2	7
Përgjigje në Ankesë për gjykatën e Apelit	1	1	/	/
Ekspertizë në favor të Kompanisë	/	/	/	/
Ekspertizë në dëm të Kompanisë	/	1	/	/
Urdhëresë për pagesë të garancisë	3	/	/	/
Ujdi gjyqësore	/	/	/	/
Kallëzime penale	/	/	7	1
Korrigjim të Aktvendimeve	/	/	/	/
Kërkesë nga Prokuroria për korigjiimin e kallëzimit penal	/	/	/	/
Ftesë nga Prokuroria	/	/	/	1
Aktvendim sipas të cilit urdhërohen debitorët	/	/	/	/
Aktvendimet e hedhura poshtë si jo të plota-anulohet- lihet jashtë fuqie	1	/	/	/
Revizion	/	/	1	/
Përgjigje në revizion	/	/	1	/
Lëndët e kryera nga tabela e lëndëve që kërcënojnë kompaninë	/	/	/	2

Punët tjera nga Zyra Ligjore

Konsultimin, analizimin dhe studimin e Projektligjeve, Ligjeve të vjetra dhe atyre të reja, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve dhe materialeve tjera lidhur me përgatitjet teorike për nxjerrjen e Rregulloreve të ardhshme të cilat duhet të harmonizohen me Ligjet dhe Aktet tjera të reja;

Me Vendim të KE-së kemi filluar punën për hartimin e Rregullores për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në K.R.U. "Hidroregjioni Jugor" Sh. A Prizren;

Me vendim të KE-së kemi filluar punën për hartimin e Rregullores për Pagat;

Kemi përgatitur Autorizime të ndryshme për përfaqësime dhe për punë tjera;

Kemi marrë pjesë në 3 (tri) Seanca të Komisionin Disiplinorë, ku i kemi përgatitur Procesverbalet, Konkluzionet si dhe Vendimet lidhur me përgjegjësinë e punonjësve sipas Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të Kompanisë.

Kemi dhënë Përgjigje në Ankesa, Përgjigje në Padi, Përgjigje në Kërkesa të punëtorëve, përgjigje dhe udhëzime për konsumatorë, përgjigje ndaj institucioneve të ndryshme si dhe personave tjerë fizik për çështje të ndryshme;

Kemi bërë përkthime të Konkurseve të Kompanisë nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Boshnjake;

Kemi marrë pjesë në Komisione për pranimin e punëtorëve në punë, dhe komisione tjera brenda Kompanisë;

Kemi pasur kontakte me Përmbauesit Privat edhe pse jo në masën e nevojshme, sidomos me Përmbauesin nga Malisheva dhe Suhareka, kjo si pasojë e mungesës të automjeteve;

Kemi pranuar konsumatorë dhe i kemi udhëzuar dhe njoftuar për procedurën përmbareshme dhe hapat që të njëjtit duhet ti ndërmarrin për pagesën e borxheve që kanë ndaj Kompanisë;

Mbetet ende i pazgjidhur problemi për transport lidhur me punët të cilat duhet ti kryejnë punonjësit e zyrës ligjore, siç është përfaqësimi i kompanisë nëpër gjykata, kontaktet me përmbaues, kontaktet me institucione tjera, ku ne problem më të madh e kemi sigurimin e transportit se sa kryerjen e punëve për të cilat neve jemi të autorizuar që ti kryejmë;

Kemi pasur një numër mjaftë të madh të lëndëve të pezulluara nga ana e gjykatave dhe tërheqje të lëndëve nga kompania, pasi që nga ana e shërbimit me konsumatorë nuk janë analizuar dhe nuk janë sanuar apo rregulluar me kohë mangësitë e lëndëve të proceduara për përmbareshme, kështu që pas procedimit të Përmbauesit privat, këto lëndë jemi detyruar që të kërkojmë që të tërhiqen gjë që bie në kundërshtim të plotë me Nenin 3 të Rregullores për iniciimin e procedurës përmbareshme të organi përmbareshme. Gjithashtu tek Shërbimi për Konsumatorë shihet se mungon evidenca e mirëfilltë e lëndëve që procedohen për përmbareshme, gjë që ndodhë që të procedohen edhe konsumatorët që e kanë kryer borxhin, procedohen konsumatorë që më parë kanë lidhur kontratë në kompani për pagesën e borxhit, kemi pasur raste që i njëjti konsumatorë të procedohet dy herë për përmbareshme. Këto dobësi të shërbimit për konsumatorë i sjellin edhe dëme materiale kompanisë ngase pas çdo tërheqje lëndësh, kompania jonë ngarkohet me pagesë të taksës administrative si dhe shpenzimeve të krijuara të përmbareshmeve privat;

**PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT
JANAR – DHJETOR 2019 NJËSIA PUNUESE PRIZREN**

	Propozime për përmbartime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Përfaqësues të përkohshëm	Të përfunduara
Janar	/	8	8	10	/	2	14
Shkurt	106	13	13	7	1	2	4
Mars	104	15	15	8	1	4	5
Prill	10	11	11	11	1	3	2
Maj	64	14	12	8	3	2	5
Qershor	10	4	6	8	3	2	2
Korrik	/	3	3	5	/	2	4
Gusht	/	4	4	6	1	1	5
Shtator	11	/	/	9	1	/	11
Tetor	24	5	5	7	/	2	3
Nëntor	79	9	9	24	1	1	12
Dhjetor	20	5	5	8	/	2	6
Totali	428	91	91	111	12	23	73

Nga Njësia Punuese e Prizrenit me Përmbartuesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **428 (katërqindtë e njëzetë e tetë)** lëndë me propozim për përmbartim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **91 (nëntëdhjetë e një) prapësime**.
- Nga kompania janë dhënë **91 (nëntëdhjetë e një) përgjigje në prapësime**.
- Janë lidhur **111 (njëqindtë e njëmbëdhjetë) marrëveshje** me debitorë.
- **12 (dymbëdhjetë) lëndë** janë tërhequr.
- Nga Gjykata janë caktuar **23 (njëzet e tre) përfaqësues të përkohshëm**.
- Janë përfunduar **73 (shtatëdhjetë e tri) lëndë**.

JANAR – DHJETOR 2019 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përmbartime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Përfaqësues të përkohshëm	Të përfunduara
Janar	/	/	/	3	/	/	4
Shkurt	/	/	/	/	/	/	1
Mars	36	1	1	7	/	/	3
Prill	/	/	/	8	/	/	2
Maj	/	1	1	7	/	/	3
Qeshor	/	/	/	7	/	/	2
Korik	/	/	/	7	/	/	10
Gusht	/	/	/	1	/	/	3
Shtator	/	/	/	6	/	/	9
Tetor	/	/	/	/	/	/	2
Nëntor	14	2	2	2	/	1	4
Dhjetor	8	1	1	3	/	/	7
Totali	58	5	5	51	/	1	50

Nga Njësia Punuese e Malishevës me Përmbartuesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **58 (pesëdhjetë e tetë)** lëndë me propozim për përmbartim
- Nga konsumatorët janë parashtruar **5 (pesë) prapësime**.
- Nga kompania janë dhënë **5 (pesë) përgjigje në prapësime**.
- Janë lidhur **51 (pesëdhjetë e një) marrëveshje** me debitorë.
- Nuk ka pasur tërheqje lëndësh.
- Nga Gjykata është caktuar **1 (një) përfaqësues i përkohshëm**.
- Janë përfunduar **50 (pesëdhjetë) lëndë**.

JANAR – DHJETOR 2019 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përmbartime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Përfaqësues të përkohshëm	Të përfunduara
Janar	13	/	/	/	/	/	1
Shkurt	/	/	/	3	/	/	1
Mars	10	1	1	/	/	1	3
Prill	/	/	/	1	/		2
Maj	/	/	/	/	/	1	1
Qershor	/	/	/	/	/	/	1
Korrik	11	/	/	1	/	/	1
Gusht	/	/	/	2	/	1	1
Shtator	/	/	/	2	/	/	2
Tetor	/	/	/	/	/	/	1
Nëntor	/	/	/	/	/	/	1
Dhjetor	1	/	/	/	/	/	4
Totali	35	1	1	9	/	3	19

Nga Njësia Punuese e Suharekës me Përmbartuesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë janë dërguar **35 (tridhjetë e pesë) lëndë** me propozim për përmbartim.
- Nga konsumatorët është parashtruar **1 (një) prapësim**.
- Nga kompania është parashtruar **1 (një) përgjigje në prapësim**.
- Janë lidhur **9 (nëntë) marrëveshje** me debitorë.
- Nuk ka pasur lëndë të tërhequra.
- Nga Gjykata janë caktuar **3 (tre) përfaqësues të përkohshëm**.
- Janë përfunduar **19 (nëntëmbëdhjetë) lëndë**.

JANAR – DHJETOR 2019 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përmbartime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Përfaqësues të përkohshëm	Të përfunduara
Janar	15	/	/	1	/	/	1
Shkurt	11	/	/	1	/	/	2
Mars	6	4	4	4	/	/	1
Prill	/	/	/	4	/	/	/
Maj	/	/	/	/	/	/	/
Qershor	/	/	/	2	/	/	1
Korrik	/	/	/	/	/	/	3
Gusht	/	2	2	/	/	/	4
Shtator	/	1	1	2	/	/	/
Tetor	/	/	/	/	/	/	3
Nëntor	11	1	1	1	/	/	4
Dhjetor	/	1	1	2	/	/	3
Totali	43	9	9	17	/	/	22

Nga Njësia Punuese e Dragashit me Përmbartuesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë gjatë vitit 2019, janë dërguar **43 (dyzetë tri) lëndë** me propozim për përmbartim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **9 (nëntë) prapësime**.
- Nga kompania janë dhënë **9 (nëntë) përgjigje në prapësime**.
- Janë lidhur **17 (shtatëmbëdhjetë) marrëveshje** me debitorë.
- Nuk ka pasur **tërheqje** të ndonjë lënde.
- Nuk ka pasur të caktuar **përfaqësues të përkohshëm**.
- Janë përfunduar **22 (njëzetë e dy) lëndë**.

6.3 LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3.	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
4.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
5.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
6.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
7.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
8.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
9.	P. 512/18 10.10.2019	Aktakuzë – lëndime të lehta trupore	E pa përcaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
10.	P.nr. 1053/2018	Propozim për përmbarim	2.974.95	Lënda gjendet në Gj. Apelit në Prishtinë

11.	P.nr. 1040/2018	Propozim për përmbarim	13,335.24	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
12.	P.nr. 1010/2018	Propozim për përmbarim	11,207.25	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
13.	P.nr. 1691/2018	Propozim për përmbarim	583,331.70	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
14.	P.nr.1804/2018	Propozim për përmbarim	4,415.06	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
15.	P.nr. 1693/2018	Propozim për përmbarim	460,849.77	Lënda gjendet në Gj. Apelit në Prishtinë
16.	P.nr. 1692/2018	Propozim për përmbarim	274,592.07	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
17.	P.nr. 1688/2018	Propozim për përmbarim	7,832.98	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
18.	P.nr. 1694/2018	Propozim për përmbarim	36,937.28	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
19.	P.nr. 1690/2018	Propozim për përmbarim	71,665.41	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë
20.	P.nr. 1689/2018	Propozim për përmbarim	22,123.25	Lënda gjendet në Gj. Apelit të Kosovës në Prishtinë

Gjatë këtij tremujori nga Gjykata e Apelit kanë ardhur këto lëndë:

1. Me datë 09.01.2019, lidhur me lëndën C.nr. 1200/2013 - kontestim i borxhit të ujit, ku Padiçesi e ka bërë tërheqjen e Padiçesë.
2. Me datë 07.10.2019 nga Gjykata Supreme ka ardhur Vendimi për lëndën C.nr. 1173/18, kontest nga marrëdhënia e punës, sipas të cilit refuzohet Revizioni lidhur me kërkesën për kthim në vendin e tij të punës (MK).
3. Me datë 08.10.2019, nga Gjykata e Apelit ka ardhur Vendim lidhur me lëndën C.nr. 1214/12, kontest nga marrëdhënia e punës, sipas të cilit pranohet Ankesa lidhur me kërkesën e punonjësit për kthim në vendin e tij të punës (RH).
4. Me datë 17.10.2019, nga Gjykata e Apelit ka ardhur Vendim lidhur me lëndën C.nr. 116/03, Padi prishja e kontratës, sipas të cilit pranohet kjo lëndë kthehet në Gjykatën Themelore të Prizrenit – Dega në Dragash në rishqyrtim dhe rivendosje (XHB).
5. Me datë 21.10.2019, nga Gjykata e Apelit ka ardhur Vendim lidhur me lëndën C.nr. 99/16, kompensim lidhur me pronën, sipas të cilit ndërprehet procedura në këtë çështje juridike, për shkak të vdekjes së padiçesit (RB).
6. Me datë 05.12.2019, nga Gjykata e Apelit ka ardhur Vendim lidhur me lëndën C.nr. 286/14, kontest nga marrëdhënia e punës, sipas të cilit kjo lëndë kthehet në Gjykatën Themelore të Gjakovës – Dega në Malishevë në rishqyrtim dhe rivendosje (FK).

Aktivite e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë dhe aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për vitin 2019

Gjatë vitit 2019 janë realizuar vizitat e objekteve të Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, janë kontrolluar të gjitha objektet në njësinë e Prizrenit, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet te “Mulliri i vjetër”, objektet dhe burimet e “40 Burimet”, objekti dhe “40 Burimeve - II “ ku janë kontrolluar gjendja e tyre, mirëmbajtja e objekteve, hapësira për rreth objekteve, si dhe është bërë kontrollimi i aparateve kundër zjarrit dhe gjendja e tyre.

Gjatë vitit 2019 përmes firmës kontraktuese “SAP-Internacional sh.p.k” në Prizren është bërë servisimi i rregullt të aparateve kundër zjarrit nëpër të gjitha njësitë e “Hidroregjionit Jugor” sipas dokumentacionit të pranimit- dorëzimit për 70 aparate: Njësia Prizren ka 41 aparate kundër zjarrit, Njësia Malishevë ka 15 aparate kundër zjarrit, Njësia Suharekë ka 9. aparate kundër zjarrit dhe Njësia Dragash ka 5. aparate kundër zjarrit.

Gjatë këtij viti janë vizituar objektet e njësisë punuese në Prizren, Suharekë, Malishevë dhe Dragash.

Është kërkuar nga menaxheret e njësive punuese që të njoftojnë me kohë për të gjitha rastet e lëndimeve në punë të punëtorëve dhe njeherit të respektojnë masat e mbrojtjes së punëtorëve dhe ligjin për sigurinë e punëtorëve në punë.

Në periudhën e vitit 2019 gjatë inspektimeve të shërbimit operativ është vërejtur se ka mangësi shumë të mëdha në përmbushjen e standardit për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë, andaj është dërguar edhe shkresë përgjegjësve të shërbimit operativ lidhur për mos sigurinë e punëtorëve në realizimin e punëve, njeherit janë të rrezikuar punëtoret sidomos gjatë hapjes së kanaleve.

Gjatë tërë viti janë bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit nëpër disa vende në qytetin e Prizrenit.

Gjatë këtij viti kemi pasur lëndime në vendin e punës të dy punëtorëve, B. Kryeziu I njësisë punuese Dragash dhe punëtori M. Sallauka njësisë punuese në Prizren, pagesa e shpenzimeve të mjekimit nga lëndimi në punë është bërë duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë.

Paraqitja e elaboratit për shërbimin e financave lidhur me blerjen e 19 kutive të ndihmës së parë për të gjitha njësit punuese: Njësia punuese Prizren me 9 kutia për ndihmën e parë për këto vende (Drejtoria, objekti i operatives, Mulliri, rezervari shpati, kuagulatorët, objekti i vjetër shadervan, stacionin e pompave Zhurë, Nashec dhe Kojushë). Njësia punuese Suharekë me 4 kutia për ndihmën e parë për këto vende (Drejtoria, depo, pusia atit, dhe baqevcë). Njësia punuese Malishevë me 3 kutia për ndihmën e parë për këto vende (Drejtoria, depo dhe stacionin e pompave në banjë). Njësia punuese Dragash me 3 kutia për ndihmën e parë për këto vende (objekti drejtorisë, objekti i filtrave, depo)

Gjatë vitit janë bërë njoftime, vërejtje dhe shënime zyrtare lidhur për mos respektimin e ligjit për sigurinë e punëtorëve në punë, për gjendjen ekzistuese të objekteve si dhe kam evidentuar të gjitha vërejtjet për mirëmbajtjen e objekteve dhe të hapësirave për rreth objekteve, njeherit është kërkuar nga përgjegjësit të ndërhyrjet në eliminimin e këtyre defekteve për ti mbrojtur asetet e kompanisë së "Hidroregjionit Jugor".

Gjatë tërë periudhës së vitit janë vizituar punëtorët në realizimin e punimeve në ndërrimin e gypave dhe ndërrimin e ndërpresave, njeherit janë kontrolluar edhe punëtoret e kompanisë sonë ku kanë realizuar punime me bashkëpunim me firmën kontraktuese.

Gjatë vitit 2019, nga Shef i Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës, janë kryer këto aktivitete:

Për çdo muaj janë përpiluar raportet mujore, për punën dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar. Gjatë çdo muaj janë përpiluar oraret e punës për çdo objekt ku kujdestarohet gjatë 24 h me tre (3) ndërrime nga ana e Rojtarëve.

Janë llogaritur angazhimet e tyre për çdo muaj, ku çdo orë shtesë, festë, vikendi apo orë nate ju është pasqyruar në llogarinë (*pagën*) e tyre personale.

Është bërë planifikimi i pushimeve vjetore të Rojeve për vitin 2019.

Fat. te ndryshme	Pajisje per Zyre	fat.ndryshme	Gold Invest	11,210.92 €
Fat. te ndryshme	Paisje makineri	fat.ndryshme	Moni-Linda-EraMed	162,841.14 €
Fat. te ndryshme	Pais. mirembajtje	Fatura të ndryshme	linda-hiterm	20,084.74 €
Fat. te ndryshme	Furnizimi me 5 Automjete	Fat. Nr.1/KRU/18	Auto mita	91,516.95 €
	TOTAL	KRU		662,507.34 €

INVESTIMET E REALIZUARA
JANAR- DHJETOR 2019
DONATORET

NR.	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	PUNËMARRËSI	KRU - HJ
	Projekti	nr.fat-prokur.	Furnitori	Vlera e Asetit
26.12.2019	Hapja puseve Gurbardh-Malishevë	Nr. I Fat. 43- Burimi	Burimi	8,573.34
18.04.2019	Projekti Mamusha	HJ-17-017-521 (31)	Burimi	9,694.94 €
16.08.2019	Pojekti "E.Haradinaj"Pz	Fat. 35+36	Burimi	20,765.64 €
08.08.2019	Pojekti "E.Haradinaj"Pz	Fat. 104+105/08	Xerxa	56,172.93 €
16.08.2019	Pojekti "E.Haradinaj"Pz	Fat. Nr. 30	Eurovia	6,769.07 €
	TOTAL-KOMUNAT			101,975.92 €
TOTAL - KRU+ DONACION				764,483.26 €

14 INVESTIMET E PLANIFIKUARA

14.1 PLANI I INVESTIMEVE KAPITALE

Plani i Investimeve është një pjese e rëndësishme e Planit të Biznesit, i cili i mundëson ujësjellësit të përmirësojë shërbimet ndaj konsumatore. Përmirësimi i shërbimeve do të ndikojë edhe në përmirësimin e moralit të pagesave tek konsumatorët.

Plani i investimeve do të përbëhet prej një përzierje të projekteve, ku disa prej tyre do të jenë pjesë e financimit nga Kompania nga të ardhurat e tyre. Megjithatë ekziston një numër i projekteve të mëdha të cilat kërkojnë financim të jashtëm edhe vlerësim të detajuar.

Qëllimi i Planit të Investimeve është që të sigurojë se Kompania është duke bërë planifikim të përshtatshëm për mirëmbajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastrukture së ujësjellësit. Identifikimi i investimeve, me qëllim të arritjes së ndryshimeve të standardeve të kualitetit apo shërbimeve shqyrtohet sipas vlerësimit të gjendjes së aseteve që janë në dispozicion me qëllim të arritjes së gadishmerisë teknike të pajimeve. Këto investime planifikohen të jenë pjesë e graveve nga KfW, MZHE, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanisë.

Ne baze të analizës dhe gjendjes momentale që kemi në terren, ne kemi përcaktuar prioritete të investimeve në nivel të Kompanisë-Ndjesive punuese.

Këto prioritete janë të domosdoshme ngase:

- përmirësohet dukshëm furnizimi me ujë
- përmirësohet cilësia e ujit
- zvogëlohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve të rinj
- zvogëlohen shpenzimet operative të mirëmbajtjes
- rritet shtimi i shërbimeve të Kompanisë
- evitohet mundësia e ndotjes së ujit të pijes nga ujërat e zeza

Planifikimi i investimeve për vitin 2020-2021-2022 është bazuar, në mundësinë e thithjeve të donacioneve si dhe programeve impementuese të Donatorë

15.1.1 Plani i investimeve- ujësjellës dhe kanalizim – NJ.P - PRIZREN

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
				INVESTITORI			
				KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Furnizimi me puseta dhe ujëmatës	PRIZREN	10,000.00	10,000.00			
2	Rehabilitimi I ujësjellesit ne rrugen Edit Durham	PRIZREN	20,000.00	20,000.00			
3	Rehabilitimi I ujësjellesit ne rrugen reshat gypin transportues 400 mm Lakoriq	PRIZREN	350,000.00		350,000.00		
4	Instalimi I rrjeti te ujësjellesi ne rruge Remzi Ademaj dhe De Rada	PRIZREN	250,000.00		250,000.00		
5	Ndrrimi I rrjetit te ujësjellesit ne rrugen Dervish Salihu	PRIZREN	360,000.00		360,000.00		
6	Instalimi I Sistemi te ujësjellesit per lagjen UÇK ne Prizren Tusus	PRIZREN	250,000.00		250,000.00		
7	Furnisimi me mjete transporti per nevojat te KRU HRJ	PRIZREN	50,000.00	50,000.00			
8	Ndertimi I Objektivit te Administrate KRU HRJ	PRIZREN	850,000.00		200,000.00	650,000.00	
9	Dislokimi I rezervuari Kalaja	PRIZREN	250,000.00			250,000.00	
10	Rehabilitimi I rrjetit te ujësjellesit ne rrugen Ulqini Pz	PRIZREN	50,000.00	50,000.00			
11	Furnizimi me Uje te pijes per fsahatrat e Rajonit te Hasit	PRIZREN	1,837,296.00	15,200.00		89,500.00	1,732,596.00
12	Rehabilitimi I zonave rurale	PRIZREN	1,500,000.00	20,000.00			1,480,000.00
13	Rehabilitimi I rrjetit ne Rr. "Ersan Mazrreku", Prizren	PRIZREN	50,000.00	50,000.00			
14	Zevendesimi I Gypit Bunari 2 deri ne Rezervoar Kurilla	PRIZREN	261,000.00				261,000.00
15	Furnizimi me Uje te pijes per fsahatrat e Rajonit te Anadrinise	PRIZREN	1,683,761.69				1,683,761.69
16	Ndrrimi I komplet rrjetit te ujësjellesit nga materiali ACC ne PE per qytetin e Prizrenit , Rikonstrukcioni dhe zonimi I rrjetit shperndares	PRIZREN	4,010,000.00	10,000.00			4,000,000.00
17	Ndertimi i rrjetit furnizues nga Filtrat deri ne rezervoarin e Novakes	PRIZREN	805,000.00	5,000.00	100,000.00	100,000.00	600,000.00
18	Implementimi i sistemit per lexim dhe faturim mobil te kompanise	PRIZREN	120,000.00	20,000.00		100,000.00	
19	Furnizimi me puseta dhe ujëmatës per konsumatorët shtëpiak dhe industrial - 2000 cope	PRIZREN	210,000.00	10,000.00	100,000.00		100,000.00
20	Rehabilitimi I rrjetit ne Rr. "Beteja e Pashtrikut", Prizren	PRIZREN	10,000.00	10,000.00			
21	Instalimi I Sistemit te Kontrollit SCADA ne nivel regjional	PRIZREN				250,000.00	
22	Rehabilitimi I rrjetit ne Rr. "Tamil Shala ", Prizren	PRIZREN	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali			12,917,057.69	270,200.00	1,610,000.00	1,439,500.00	9,857,357.69

INVESTIMET
N.J.P. – SUHAREKË - JANAR-DHJETOR - 2020

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
				INVESTITORI			
				KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Peqan para futjes nën menagjimin e kompanisë	SUHAREKË	80,000.00	40,000.00 €	40,000.00 €		
2	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Bllacë para futjes nën menagjimin e kompanisë	SUHAREKË	65,000.00	35,000.00 €	30,000.00 €		- €
3	Ndërtimi i Ujësjellsëve të ri, për fshatin Nepërbisht	SUHAREKË	56,548.97				56,548.97 €
4	Ndërtimi i DIGES se Dragaqines	SUHAREKË	5,500,000.00				5,500,000.00 €
5	Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen e Plisit në fshatin Grejkoc	SUHAREKË	30,000.00	- €	30,000.00 €		
6	Ndërtimi i Ujësjellsëve të ri, për fshatin Maqitevë	SUHAREKË	125,286.22				125,286.22 €
7	Ndërtimi i Ujësjellsëve të ri, për fshatin Reqan	SUHAREKË	223,815.00				223,815.00 €
6	Ndërtimi i rezervuarit si dhe sistemi të furnizimit me ujë tek Pusi I Atit	SUHAREKË	521,000.00	1,000.00 €	250,000.00 €	270,000.00 €	
Totali			201,548.97	76,000.00	350,000.00	270,000.00	5,905,650.19
	EMRI I PROJEKTIT Ujrat e Zeza						
7	Regullimi i kanalizimit në fshatin Bllac	SUHAREKË	19,000.00		19,000.00 €		
8	Ndërtimi i kanalizimit në Komune	SUHAREKË	176,500.00		176,500.00 €		
9	regullimi i kanalizimit në fshatin Studenqan	SUHAREKË	10,000.00		10,000.00 €		
	Ndërtimi i ITUZ biologjik për fshatin Bukosh	SUHAREKË					150,000.00 €
Totali			205,500.00	-	205,500.00 €	-	150,000.00 €

INVESTIMET
NJ.P. – MALISHEVË - JANAR-DHJETOR - 2020

	EMRI I PROJEKTIT	NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
				INVESTITORI			
				KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Rehabilitimi i rrjetit te ujesjellsit ne fshatin Banje (zgjerim i rrjetit, Ø 110mm),lagja e Samadraxhve.	MALISHEVË	90,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00
2	Zgjerim te rrjetit te ujesjellsit ne Malisheve (Ø 75mm).	MALISHEVË	49,000.00		9,000.00	20,000.00	20,000.00
3	Furnizim me pompa 25 kw ne S.P. Banje	MALISHEVË	14,000.00	4,000.00	10,000.00		
4	Furnizim me pompa 7.5 kw ne S.P. ne Maxharr, Kravasari dhe Bubel	MALISHEVË	21,000.00	10,000.00	11,000.00		
5	Furnizim me mjete pune (Eskavator, kamioneta).	MALISHEVË	30,000.00	14,000.00			16,000.00
6	Furnizim me pompa 55 kw ne S.P. Banje	MALISHEVË	45,000.00	22,500.00	22,500.00		
7	Furnizim me pompa 18 kw ne S.P. ne Gurbardh,7.5 kw ne S.P.ne Lladroce.	MALISHEVË	15,000.00	5,000.00	10,000.00		
8	Furnizim me mjete pune (Eskavator , kamioneta).	MALISHEVË	50,000.00	4,000.00		30,000.00	16,000.00
9	Rehabilitimi e gypit magjstral Ø 315mm (Rezervuar Bajë der Malisheve). L= 5.4 km	MALISHEVË	314,000.00		160,000.00	154,000.00	
10	Rehabiltimim i rrjeti Ø160mm ruga Ibrahi Mazrreku, Malisheve dhe rruga Adem Jashari L=2240	MALISHEVË	72,000.00		72,000.00		
Totali			700,000.00	59,500.00	324,500.00	234,000.00	82,000.00
EMRI I PROJEKTIT Ujrat e Zeza							
1	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Carralluk	MALISHEVË	30,000.00	5,000.00	25,000.00		
2	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Malisheve	MALISHEVË	30,000.00	10,000.00	20,000.00		
Totali			60,000.00	15,000.00	45,000.00	-	-

INVESTIMET
NJ.P. – DRAGASH - JANAR-DHJETOR - 2020

EMRI I PROJEKTIT		NJËSIA	VLERA NË- €	2020			
			903,050.00	INVESTITORI			
				KRU- HJ	K.KOMUNAL	QEVERIA	DONATOR
1	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 90 mm (Dragash).	DRAGASH	5,950.00		5,950.00		
2	Riparimi I objektit te fabrikes se trajtimit te ujit ne Dragash		30,000.00	20,000.00	10,000.00		
3	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 200 ACC mm (Dragash).		150,000.00		150,000.00		
4	Ndertimi I Objektit te Administrate KRU HRJ njesia punuse Dragash		250,000.00			250,000.00	
5	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Radesh der Dragash		247,500.00		247,500.00		
6	Furnizim me mjete pune (Eskavator, vetura, kamioneta).		40,000.00	10,000.00		30,000.00	
7	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 110 mm (Dragash).	DRAGASH	3,600.00	3,600.00			
8	Furnizim me mjete pune (Eskavator, vetura, kamioneta).	DRAGASH	24,000.00				24,000.00
9	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit Ø 125 mm (Dragash der ne Pllave). L= 5km	DRAGASH	50,000.00		50,000.00		
Totali			801,050.00	33,600.00	463,450.00	280,000.00	24,000.00
EMRI I PROJEKTIT Ujrat e Zeza							
1	Rehabilitimi dhe ndërtimi i kanalizimeve ne Dragash	DRAGASH	102,000.00	2,000.00	50,000.00	50,000.00	
Totali			102,000.00	2,000.00	50,000.00	50,000.00	-

INVESTIMET**JANAR-DHJETOR - 2020**

	INVESTIMET NGA MJETET VETANAKE	
Nr		2020
1	NJ.P. PRIZREN	417,800.00
2	NJ.P- SUHAREKË	76,000.00
3	NJ.P. - MALISHEVË	74,500.00
4	NJ.P. - DRAGASH	35,600.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	25,000.00
	KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN	628,900.00

	INVESTIMET NGA GRANDET/ DONACIONET	
Nr		2020
1	NJ.P. PRIZREN	19,041,857.69
2	NJ.P- SUHAREKË	6,881,150.19
3	NJ.P. - MALISHEVË	685,500.00
4	NJ.P. - DRAGASH	867,450.00
5	NJ.P. - MAMUSHË	25,000.00
	KRU,, HIDROREGJIONI JUGOR" SH..A - PRIZREN	13,955,413.77

15. RAPORT NGA MENAGJERET E PROJEKTEVE

15.1 Ndërtimi i kolektorit dhe Impiantit per Trajtimin e Ujerave te zeza – Prizren (ITUZ)

Si rezultat I gjendjes jo te knaqshme te sherbimeve me sistemin e kanalizimit ne aspektin e funksionalitetit per te perballuar ujerat urbane ne pergjithesi duke perfishire ujerat e zeza, ujerat industriale dhe ujerat e shiut ne qytetin e Prizrenit , ka rjedh nevoje qe te perpilohet nje studim I mirfillt per gjendjen e ujerave urbane per qytetin e Prizrenit, prandaj eshte filluar me Studimin e Fizibilitetit te perpiluar ne vitin 2006 te investuar nga Qeveria Federale Gjermane permes Bankes Gjermane per Zhvillim (KfW), konkretisht verzionit final te ketije studimi 10/2011 per Asgjesimin e Ujerave te Ndotura ne Kosoven Jugperendimore, konkretisht Studimi I Fizibilitetit per qytetin e Prizrenit me nr. te projektit 610-1154 , me te vetmin qellim per te ngrite shkallen sanitare per qytetin e Prizrenit ne pergithesi, per te mbrojtur shendetin e populates, ujerat nentokesore, ujerat siperfaqesore ne veçanti, e sidomos per te permbushur nje nder kriteret e Bashkimit Evropian qe Ujerat e Ndotura te shkakrohen ne shtetet tjera si te trajtuara.

Bazuar ne kete studim te Fizibilitetit si baze per zhvillimin e ketije projekti na eshte dhuruar granti nga Qeveria Federale Gjermane I cili eshte realizuar me automatizem nga ish Presidentja e Republikes se Kosoves shkelqesia e saje zonja Atifete Jahjaga, ky Grant I paster pa asnje interes eshte jetesuar permes dy Marrevshjeve Financiare te projektit ndermjet KfW-se si dhurues, Ministrise se Financave si marres dhe KRU" Hidroregjionit Jugor" si perfitues I ketije Granti te nenshkruara ne vitin 2012.

Marreveshja e pare eshte ne vlere prej 8 milion euro (7+1) dhe marreveshja e dyte eshte ne vlere prej 4 milion Euro. *(Marreveshjet financiare origjinale te nenshkruara nga palet gjenden ne Kompanine KRU"HRJ"sh.a dhe munde te prezantohen ne cdo moment).*

Pas ketyre marreveshjeve financiare per kete project eshte perpiluar Marreveshja e Veçant e cila eshte jetesuar me nenshkrimin e saje ndermjet paleve si: Banka Gjermane per Zhvillim si investitor, Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapsinor si garantuese e fondit nga kontributi vendor, Komuna e Prizrenit – si garantuese e sigurimit te lokacionit ku do te ndertihet ITUN, konkretisht shpronosit te tokes se nevojshme per ndertimin e ITUZ-se dhe fondeve eventuale shtese te cilat do te nevojiten per kompletimin e ketije projekti dhe KRU" Hidroregjionit Jugor" si Agjencion Ekzekutues I Projektit.

Per implemetimin e ketije projekti me inicimin e KfW-se eshte percaktuar Agent Tenderi I cili ka perzgjedhur Kompanine Konsulente e cila ka per detyre qe te pergadise dokumentacionin e tenderit, te dizajnoj projeke sipas kontartes dhe te mbikqyr projektin deri ne fund te implementimit per te dy fazat e projektit. Kontrata me Kompanine konsulente eshte nenshkruar ne vitin 2013.

Projekti perbehet prej dy fazave, Faza 1 ka te beje me ndertimin e kolektorit kryesor ne rruge ana e majte e rrjedhes se lumit Lumbardhi se bashku me kaperderdhesit per reshjet e shiut, faze kjo e cila tani me eshte perfunduar dhe Faza 2, Dizajnimi dhe ndertimi ITUZ-se e cila eshte shume afer perfundimit.

Kontrata "Asgjesimi i Kanalizimeve në Jugperëndim të Kosovës; Faza 2 - Dizajnimi, furnizimi dhe instalimi i WWTP në Prizren "u nënshkrua më 5 Maj 2015 midis Punëdhënësit Hidroregjioni Jugor dhe Kontraktuesit, Sipërmarrje e përbashkët (Joint Venture) Aqualia infraestructuras S.A. (si udhëheqës) dhe Hidroterm.

Kushtet e kesaje kontrate Dizajn dhe Ndertim vlejne sipas Librit te verdhe te FIDIK-ut (FIDIC Yellow Book, Edition 1999). Procedurat e Prokurimit per kete kontrate u zhvilluan sipas Udhëzimeve të Prokurimit të KfW-se.

Për shkak të vonesave në shpronësimin e tokës dhe çështjeve tjera administrative absolutisht pa fajin e AEP-se qe ka te beje me posedimin e Lejes së Ndërtimit si kusht themelor per fillimin e zbatimit te kontartes , ndërtimi i WWTP Prizren filloi më **25 qershor 2017**, nderkaq kontrata me pukekryesin ishte nenshkruar me

5 Maj 2015 qe nenkupton se punimet kishin filluar me nje vonese prej 26 muajve, per kete vonese pundhenesi bazuar ne marrveshjen kontraktuale ka qene I obliguar qe te paguaj kompenzim prej rreth 320,000.00 Euro neto, keto mjete jane paguar nga komuna e Prizrenit si garantuese e kostos shtese. Kohëzgjatja fillestare e kontratës ishte 18 muaj dhe Data e Përfundimit te projektit u caktua me **31 Dhjetor 2018**.

Gjatë tremujorit të dytë 2018, përparimi i punimeve të ndërtimit filloi të ngadalësohet ndjeshëm. Vonesat kanë ndodhur për shkak të procesit të ngadaltë në marrjen e aprovimit nga KEDS per dislokimin e linjes 10 KV (kilovolteshe) e cila duhej te dislokohej dhe kjo leje është leshuar ndërkohë si dhe përparimit relativisht te ngadaltë te disa pjesëve të punëve civile.

Për shkak të kushteve të këqija të motit në dimër perfshire vitet 2017/2018, në tetor te vitit 2018 sipas konsulences dhe miratimit te KfW-se u vendos që koha e perfundimit te projektit te zgjase edhe per dy muaj, pra u vendos qe projekti te perfundoj deri me **28 shkurt 2019**.

Sidoqoftë, për shkak të performancës së pakënaqshme të Kontraktuesit, u bë e qartë se punimet e ndërtimit do të zgjasin më shumë. Punëdhënësi HRJ dhe Konsulenti kanë zhvilluar takime të shumta me Kontraktorin për të shpejtuar përparimin e punimeve.

Konsulenti me miratimin e HRJ-se I ka derguar leter kontraktorit Ne muajin Shtator dhe Tetor te vitit 2018 bazuar ne Klauzolen 8.6 te FIDIK-ut qe ka te beje me "Shkallen e progresit te punimeve" me te cilen e ka njoftuar per shkallen e ngadalte te progresit te punimeve dhe ne Janar te vitit 2019 nje leter tjeter per "nivele e performances se paknaqshme" duke I kerkuar qe te marr masa per rikuperimin e ketyre vonesave.

Pas shume takimeve dhe presioneve tek kontaktori nga ana e konsulentit dhe HRJ-se në një takim te dates 6 Mars 2019, Kontraktori emëroi një "Menaxher të ri te Përkohshëm të Ndërtimit" për të mbështetur Ekipin e Kontraktuesit në vendpunishte deri në perfundimin apo venien ne funksion te implantit. Me kete angazhim nga Kontraktori fillimi i komisionimit ishte fundi i **qershorit 2019** dhe kjo dukej akoma realiste, mirpo me gjithë optimizmin e përkohshëm, i cili doli nga ai takim, problemet në vendpunishte mbetën të njëjta. Kontraktuesi vazhdonte të tejkalonte orarin e tij dhe I neglizhonte udhëzimet e dhëna nga Konsulenti.

Prandaj, ne si Punëdhënësi me udhezimet nga konsulenti e konsideruam veten qe kemi të drejtë qe te na paguhen demet nga keto vonesa dhe me date **24 maj 2019** e njoftuam me shkrim Kontraktuesit per kete çeshtje.

Në qershor, u vlerësua se para-komisionimi i WWTP Prizren do të fillonte në shtator 2019.

Pas shqetesimit nga KfW si financuese e ketije projekti dhe neve si punedhenes u inicua takimi I parë Special I cili u mbajt në **4 korrik 2019** në zyrën e KfW në Prishtinë. Gjatë Takimit special, u ra dakord per një sërë aktivitetesh te mehereshme që duhej të kishin përfunduar deri në shtator 2019 për te pas mundesi inaugurimin e perfundimit te ketije projekti pargjate festimit te 20 vjetorit të Bashkëpunimit Financiar Gjerman me Kosovën.

Më tej në takim, Kontraktuesi dorëzoi Raporte Javore të Progresit që raportojnë për përparimin e pikave të shtatorit. Inxhinieri monitoroi përparimin gjatë mbikëqyrjes së tij të përditshme të vendpunishtes dhe takimeve javore me Kontraktorin.

Pavarësisht nga kjo, Konsulenti vërejtë se progresi ishte prapa afateve të dakorduara dhe se nuk u mor asnjë masë serioze nga Kontraktuesi për të shpejtuar përparimin. Si pasojë, Konsulenti lëshoi disa udhëzime tek Kontraktuesi, duke specifikuar kohën deri në të cilën punimet duhet të përfundojnë.

Gjatë Takimit të dytë Special të mbajtur në zyrën e HRJ-se me datë **21 Gusht 2019**, përfaqësuesi i KfW në Kosovë, Drejtori i Përgjithshëm i HRJ dhe Konsulenti kërkuan që numri i punëtorëve në vendpunishte të rritet ndjeshëm.

Aktualisht, rreth 95% e punimeve të ndërtimit kishin përfunduar, por Kontraktori po përballë me vështirësi të përmbushë disa kërkesa të KEDS për transformatorin. Këto kërkesa duhet të përmbushen para se WWTP të lidhet me rrjetin e furnizimit me energji elektrike.

Me kusht që këto probleme të tejkalohen shumë shpejt, Kontraktori parashikon që ITUZ mund të merret në veprim në **dhjetor 2019**.

Duke rishikuar kërkesën e HRJ për pagesa, Inxhinieri "p2m berlin GmbH-IDOM-ALB Architect" përcaktoi që pas **28 shkurtit 2019**, me letrën e tij të datës 26 gusht 2019 në lidhje me përcaktimin për aplikimin e dëmeve të vonesës, Inxhinieri përcaktoi që Punëdhënësi, Hidroregjioni Jugor, ka të drejtë në përputhje me **FIDIC YB, SC 8.7** [Dëmtimet e vonesës] për pagimin e dëmeve të vonesës nga Kontraktori pas datës **6 Korrik 2019**.

Periodha e aplikimit të dëmeve të vonesës u përcaktua të zgjasë deri në leshimin e certifikates për praninë teknike të perkohshme (Taking over certificate).

Periodha maksimale për aplikimin e Dëmeve të Vonësës ka skaduar me 14 Tetor 2019. Kjo do nënkuptojë që është plotësuar vlera e dëmeve nga 10 % e kontratës dhe pas kësaj date HRJ mund të fillojë me aplikimin për kompenzim të një pjese të dëmeve për shkak të vonësës.

Prandaj, HRJ ka të drejtë për shumën maksimale të dëmeve të vonësës (10 (dhjetë)% të çmimit të kontratës përfundimtare në shumën prej 1,035,451.24 EUR në përputhje me FIDIC YB, SC 8.7 [Dëmtimet e vonësës]. Në këtë kusht ekspertët FIDIC-ut nga ana e Inxhinierit-konsulencës konfirmoi që Hidroregjioni Jugor ka të drejtë të dërgojë një kërkesë për kompenzimin e dëmeve para se të leshohet Pranimi Teknik i perkohshëm. *(Gje të cilën e kundërshtonte kontraktori, duke thënë se pa përfunduar komplet projektin dhe të përcaktohet vlera investive nuk kemi të drejtë të kërkojmë dëmet për shkak të vonësës, gjithashtu kontestoni kohën e cila u shkaktua në kontestin e kontraktorit me KEDS-in).*

Në përputhje me kontratën, dëmet e vonësës do të llogariten në bazë të çmimit përfundimtar të kontratës. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton që Dëmtimet e Vonësës mund të aplikohen vetëm pasi të merren punimet dhe të gjitha variacionet dhe pretendimet janë zgjidhur dhe mbyllur.

Në përputhje me **FIDIC YB, SC 2.5** [Kërkesat e punëdhënësit], shumat e pjesëshme të dëmeve të vonësës tashmë mund të zbriten nga IPC-të para se të leshohet TOC Pranimi Teknik i perkohshëm.

Në këtë drejtim, synohet të zbritet një pjesë e dëmeve të vonësës nga faturat e Kontraktuesit për Kërkesën Nr. 13 (483,339.78 EUR) dhe për Shlyerjen e Parave të Mbajtjes së MESP (481,871.02 EUR). Mbetjet e dëmeve të vonësës arrijnë në $1,035,451.24 - 483,339.78 - 481,871.02 = 70,240.44$ EUR. Synohet të zbritet kjo pjesë e mbetur e dëmeve të vonësës nga faturat e rradhës të Kontraktuesit.

Parakomisionimi I ITUZ-se ka filluar, nësi AEP I kemi dërguar dy teknik dhe 3 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e ITUZ-se dhe Menaxherin Teknik të ITUZ-se, sipas kërkesës së kontraktorit do të vendoset stafi I ITUZ-se dhe meqenese trajnimet do të fillojnë nga mesi I muajit shkurt 2020 në jemi në përfundim të rekrutimit të stafit.

Sipas aktiviteteve aktuale të cilat janë duke u zhvilluar dhe sipas orarit të dhënë nga Kontraktori, ITUZ do të fillojë operimin në fund të muajit Prill.

15.2 Programi Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale Faza e VI-të

Fillimi i fazës së VI-të

*Jemi në realizim e sipër të projekteve të planifikuara për fazën së VI-të ku disa projekte kanë fillue të realizohen e disa janë në pergaditje e sipër për tu Tenderue :

Në Prizren :

- Zona e Hasit ka fillue projekti i rehabilitimit të rrjetit , Investimet në Efiqenca e energjisë elektrike , Rehabilitimi i rezervareve në Kojush1 dhe Kojush 2 , Rezervari i Kobaj , rrjeti i ri ujësjellesit dhe ndertimi i pusetave në rrugë për Fshatin Mazdrek , punimet në vijim .

Humbjet e ujit :

Kufizimi i zonave te reje ,Lagjeja e Kurilles , Zona e Hasit , Dardanija (Ndertimi i pusetave me ujëmatësave në trotuar) , projektet janë në vijim ,

Projekte e reja :

Sistemet e reja të ujësjellësave në Lagjen e Janinës , Fshati Landovicë, punimet në vijim

Në Suharekë:

*Projekte e sistemeve të reja të ujësjellësave në fshtrat ,Suharekë, Reqan, Neprebisht, Maqitevë punimet në vijim.

*Humbjet e ujit ,Fshati Reshtan ndërtimi i rrjetit kryesor dhe ndërtimi i pusetave në trotuar per tërë fshatin , Fshatin Studenqan , Fshatin Sopi

* Ndertimi i impiantit biologjik për trajtimin e ujrave të zeza në fshatin Bukosh

Në Malishevë :

Ne Humbjet e ujit në Fshatin Astrazub

Investimet e reja nësistemin e ri të ujësjellësave për fshatrat Temeqin dhe Janqisht

Këto investime duhet të perfundojn në vitin 2020

Në vazhdim po ju bashkangjes edhe listen e projekteve me vleren e kontratuar deri me tani :

15.3 PROJEKTI PËR RIPËRTRITJE TË ENERGISË DHE ENERGISË EFIÇIENTE

1. Titulli i programit;	Projekti rajonal - Prizren për ripërtrirje të energjisë dhe energjisë efiçiente.
Titulli I projektit;	“Ndërtimi i gypsjellësit të ri në segmentin 40 Bunarët – rez. ‘Shpati’ respektivisht kyçja në rrjetin e qytetit të Prizrenit”.
Përfituesi;	KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren
Donatori;	Qeveria Gjermane – BMZ - 2007 65 941
Agjensioni financiar;	KFW – Banka zhvillimore
Fondi total i programit;	2.5 mln Euro
Data e Marrëveshjes;	11.12.2013
Palët e marrëveshjes;	1. KFW, 2. Ministria e Financave e Republikës së Kosovës 3. KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, Prizren
Konsulenca;	p2mberlin – ndërmarrja kryesore IDOM – partner Alb-Architect, nënkontraktor
Data e kontratës me konsulencën;	14.05.2014
Punëmarrësi;	“RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus”
Data e kontratës;	17.05.2017
Vlera e kontratës;	<u>1,925,152.68 €.</u>
Plani dinamik I paraparë;	9 muaj
Plani i dinamik i propozuar;	17 Korrik 2017 – 17 Prill 2018 (9 muaj)
Plani dinamik i reviduar;	17 Gusht 2017 – 5 Nëntor 2018 (446 ditë)
Plani dinamik rireviduar;	09.10.2017 - 13.02.2019
Përfundimi I punimeve;	20.06.2019
Periudha e përgjegjësisë dhe përfundimt të projektit;	Një vit pas përfundimit të punimeve dhe pranimit teknik (Qershor 2020)
Memorandumi i Mirëkuptimit (MM):	Pas disa takimeve konsultative dhe shkëmbimit të informacioneve e të dhënave të kërkuara, me datën 15.12.2016 është nënshkruar MM në mes 4 palëve; MI, KK-Prizren, KRU “Hidroregjioni Jugor” dhe konsulenca “p2mberlin”. Me këtë MM është siguruar edhe Pëlqimi adekuat për zhvillimin e punimeve konform lejes urbanistike dhe konditave të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Punimet shtesë për shkak të zhvendosjes së trasës:

- Studimi gjeoteknik (16.08.2017)
- Ridizajnimi i trasës (05.10.2017)
- Barazimi financiar i punimeve shtesë sipas urdhëresave të aprovuara nga KFW.
- Harmonizimi i planit dinamik konform ndryshimeve (3 muaj vonesë e arsyeshme në emër të aktiviteteve të mësipërme)
- Pëlqimet dhe aprovimet përkatëse shtesë.

Statusi i fillimit të punimeve – Tetor 2017:

- Punimet kanë filluar me datë 09.10.2017 (3 muaj me vonesë për arsyet e mësipërme)
- Vazhdon furnizimi me gypa PEHD OD 800 dhe OD 630 mm
- Është kërkuar nga banka – KFW, aprovimit i urdhërit për ndryshimin e punimeve për kanal - nr. 2, në vlerë rreth 395 mijë €.
- Jemi në fazën finale të harmonizimit të punimeve në ndërtimin e komorës së re mbledhëse të 40 Burimet dhe ndërrimin e trasës së re të gypave 2 x \varnothing 400 mm dhe \varnothing 225 mm duke përfshirë edhe ndërtimin e pusëve 1 dhe 2 me dimensione të reja konform situacionit të ri të punimeve në Task “B”.

Statusi final i përfundimit të punimeve (20.06.2019);

Sipas planit të paraparë dinamik, pas vendosjes complete të gypsjellësit PEHD OD 800 mm² në gjatësi $L \approx 3.2$ km, nga komora mbledhëse të “40 Burimet” gjer te rezervuari kryesor i qytetit – “Shpati”, janë përfunduar punimet e parapara sipas kontratës duke përfshirë edhe punimet shtesë në të gjitha njësitë punuese të këtij projekti:

- Është përfunduar komora mbledhëse CC700 te lokacioni “40 Burimet” duke respektuar standardet bashkohore për trajtimin e ujit të pijes, që akumulon të gjitha burimet ekzistuese dhe burime tjera të ujit të pijes në perspektivë.
- Janë përfunduar kyçjet e rrjetit të vjetër në infrastrukturën e re hidraulike të CC700.
- Është përfunduar kyçja e gypsjellësit të ri në rezervuarin kryesor – “Shpati”
- Janë përfunduar testimet, dezinfektimet dhe pastrimet e rrjetit të gjithmbarshëm hidraulik të gypsjellësit.
- Është lëshuar në shfrytëzim gypsjellësit kryesor me infrastrukturën përcjellëse hidraulike
- Janë përfunduar punimet në rregullimin e terrenit, mureve dhe bazave mbrojtëse dhe disa punime tjera rreth përmirësimit të vërejtjeve të shqiptuara gjatë mbikqyrjes.
- Është lëshuar Çertifikata e pranimit teknik më, 20.06.2019 dhe tërë projekt dokumentacioni tekniko - investiv.
- Nga data 21.06.2019 vazhdon periudha e përgjegjësisë nga kontraktori deri 20.06.2020.

- Jemi në pritje të raportit final nga konsulenca (brenda javësh), që duhet të aprovohet nga departamenti financiar pranë KFW-së dhe që duhet të përfshijë të gjitha të dhënat dhe informatat rreth projektit dhe punimeve deri te objektivat, efektet dhe benefitet nga ky investim.

Pagesat e ekzekutuara - Gypsjellësi:

Avansi në vlerë;	288,256.90 € (15 %).
IPC 1.....	148,130.13 Euro
IPC 2.....	267,921.60 Euro
IPC 3.....	157,019.42 Euro
IPC 4.....	308,591.94 Euro
IPC 5.....	254,629.94 Euro
IPC 7.....	163,812.54 Euro
IPC 10.....	188,034.12 Euro
IPC 11.....	162,831.87 Euro
5 % e ndalesës...	102,064.66 Euro

Gjithsej të paguara ; 2,041,293.12 euro (pa TVSH)

Konsulenca (p2mberlin):

Gjithsej deri 12/2019.....	436,488.71 Euro
Mbetja për 12/2020.....	16,548.00 Euro

Gjithsej të parapara për pagesë; 453,036.71 Euro (pa TVSH)

Gjithsej; Gypsjellësi + konsulenca

Gypsjellësi.....	2,041,293.12 Euro
Konsulenca.....	453,036.71 Euro

Gjithsej të parapara për pagesë; 2,494,329.83 Euro (pa TVSH)

Mbetja nga fondi 2.5 mln Euro;

5,670.17 Euro (pa TVSH)

Impianti - Gypi shkarkues;

IPC 6.....	137,691.62 Euro
IPC 8.....	74,101.11 Euro
IPC 9.....	30,174.93 Euro

Gjithsej të paguara ; 241,967.66 Euro (pa TVSH)

Mbështetja nga Komuna e Prizrenit përmes Marrëveshjes nr. 2573/12.10.2018;

NPT "Xërxa",	129,872.70 Euro
"RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus",	69,733.62 Euro

Gjithsej të paguara ; 199,606.32 Euro (me TVSH)

Mbështetja nga KRU "Hidroregjioni Jugor", Marrëveshja nr. 548/30.03.2018

"RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus", **108,205.30 Euro**

Gjithsej të paguara ; 88,445.75 Euro (me TVSH)

Rekapitullim i të gjitha mjeteve të investuara për gypsjellësin:

KFW.....	2,041,293.12 Euro (pa TVSH)
Komuna e Prizrenit (Marrëveshja 2573/12.10.2018).....	169,066.55 Euro (pa TVSH)
Ministria e Infrastrukturës (Zotimi 4286/11.05.2018-asfalti)	205,889.27 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (Marrëv. 548/30.03.2018)...	74,958.48 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (fondi i mirëbesimit).....	33,880.00 Euro (pa TVSH)
KRU" Hidroregjioni Jugor" SH.A (punimet shitesë).....	118,282.42 Euro (pa TVSH)
Gjithsej;	2,643,369.84 Euro (pa TVSH)

Objektivat dhe përfitimet;

- Donacion në vlerë rreth 2.5 mln Euro, pa asnjë detyrim kthimi.
- Zëvendësimi i gypave ekzistues të azbestit me gypsjellës tip PEHD, i impregnuar dhe i veshur me të gjitha shtresat e avansuara mbrojtëse, identifikuese dhe sinjalizuese me dimensione DN-700 mm, OD 800 mm. Me këtë zëvendësim është përfituar në :
 - ✓ Përmbushja optimale e standardit për shërbim të konsumatorëve
 - ✓ Ruajtja e shëndetit public përkatësisht shmangija dhe privimi nga mundësia e efekteve kancerogjene.
 - ✓ Reduktimi maksimal i humbjeve të ujit gjatë prurjes (transmisionit).
 - ✓ Uljen e kostos së mirëmbajtjes dhe lehtësi e sanimit të prishjeve. Këto intervenime në gypsjellësin e vjetër (azbestit) krijonin shumë vështërsi punuese, rrezikshmëri për shëndet e ambient dhe kanë gjeneruar në vazhdimësi kosto të lartë për shkak të specifikave intervenuese.
- Prurja e ujit të pijes në gypsjellës me kapacitet minimal $Q = 530$ l/s që korrespondon mjaftueshëm për rreth 230 mijë banorë, sipas kalkulimeve të raportit 200 l/person/ditë.
- Akumulimi i të gjitha burimeve dhe prurjes së tërë sasisë së ujit në të gjitha periudhat përfshi edhe periudhat e rritjes maksimale të kapaciteteve të puseve që sigurohet në vendburimin 40 Burimet, burimet ndihmëse dhe burimet që mund të sigurohen në perspektivë në këtë zonë.
- Siguria dhe mbrojtja adekuate e cilësisë, kualitetit dhe kuantitetit të ujit të furnizuar.

- Sipas studimit të fisibilitetit, është projektuar mënjanimi nga prodhimi i 3 elektropompave me fuqi 3 x 45 kW të stacioneve pompuese Bunar I dhe II respektivisht ulje e konsumit energjetik për ≈ 370000 kWh apo mesatarisht rreth 27,000.00 € në vit. Ky objektivi ende nuk është realizuar sepse disa zona tjera të qytetit të cilat nuk mbulohet furnizimi nga gypsjellësi I ri, për shkak të thatësisë të gjatë dhe zvogëlimit të kapaciteteve të puseve, për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë edhe për këto zona të lartëcekura, po sigurohet ujë nga gypsjellësi I ri dhe po detyrohem në aktivizimin e të gjitha pompave në dispozicion për zonat tjera të qytetit sikurse edhe për shkak të shtimit të lagjeve dhe konsumatorëve të ri. Sipas matjeve dhe analizave aktuale, rezulton se kjo gjendje do të ketë jetëgjatësi të shkurtër duke llogaritur në stabilizimin e kapaciteteve ujore të qytetit dhe duke u përkrahur me aktivitetet që vazhdojnë pandërprerë në zvoglimin e humbjeve të ujit.
- Sipas analizave nga shërbimi teknik I Kompanisë, duke krahasuar gjendjen paraprake të furnizimit dhe gjendjen pas vendosjes së gypsjellësit në zonat e furnizimit si më poshtë:
 - ✓ Lagje Dardania
 - ✓ Lagje Kurilla
 - ✓ Lagje Bazhdarana
 - ✓ Lagje Gurishta
 - ✓ Rr. Ukë Byryqi
 - ✓ Rr. Janina

Pas vendosjes së gypsjellësit të ri, kemi këto efekte:

- Furnizimi me ujë për 24 h (para gypsjellësit të ri furnizimi për këto lagje ishte prej 9 deri 16 h në ditë), stabilizimi i presionit të ujit në zonat e epërme të qytetit dhe menjanimi nga funksioni i hidroforeve personal që kane gjeneruar shpenzime shtese per konsumatoret.

Sipas llogaritjes së përafërt, për zonat e sipërshenuara, që rezulton rreth 3000 konsumatorë apo rreth 17000 banorë, nga numri i konsumatorëve me shfrytëzim të paisjeve shtëpiake për ngritjen e shtypjes së ujit (hidroforeve) dhe konsumit energjetik për to, rezulton se brenda vitit vetëm kursimi i energjisë elektrike nga ndërprerja e punës së hidroforeve, arrin në 398500 kWh apo 27,900.00 €.

Llogaritja e përafërt:

$3000 \text{ kons} \times 50 \% = 1500 \text{ kons} \times 0.650 \text{ Wat} = 975 \text{ kW} \times 16\text{h} \times 7 \% = 1092 \text{ kWh/ditë} \times 365 \text{ ditë} = 398500 \text{ kWh} \times 0.070 \text{ €} = 27,900.00 \text{ €/vit.}$

Për sqarim plotësues, këtij raporti ia bashkangjesim hartën zonale të qytetit të identifikuar me zonat që kanë përfituar nga gypsjellësi drejtpërdrejtë dhe indirekt.

- Komora e re mbledhëse (CC700) mundëson menaxhimin efikas, monitorimin, kontrollin, klorinimin, matjet dhe preventimin e ndotjes eventuale nga të reshurat.


- Mundësia e ndarjes zonale dhe operimit efikas gjatë ndërprerjeve selective të linjave furnizuese të qytetit (task B)
- Rritja e besimit dhe disponimit qytetar.

Aktivitetet e perealizuara në mungesë fondesh;

- Ndërtimi dhe funksionimi i Njesisë së klorinimit – sipas pozicionit opcional në kontratë - **158,965.00 €**
- Renovimi, izolimi, dezinfektimi dhe ndërrimi I infrastrukturës hidraulike të rez. “Shpati”.
- Ndërrimi I gypit ekzistues AC Ø 630 mm nga Rez “Shpati” gjer te nyja zonale “34”, në gjatësi L = 200 m.
- Ndërtimi i infrastrukturës complete të hapësirës së zonës përkufizuese të 40 Burimet sipa zonave të sigurisë dhe projektit detal zbatues.

Dokumentacioni;

- Është dorëzuar komplet dokumentacioni tekniko-investig nga konsulenca (p2mberlin & IDOM&Alb-Architect) me datë 20.06.2019.
- Është dorëzuar dokumentacioni, korrektimi dhe vlerësimi final i punimeve shtesë nga konsulenca (p2mberlin & IDOM&Alb-Architect) sipas Ref. nr. R/I: 88, e datës 05.11.2018 dhe Ref. nr. R/I: 118, datë 18.04.2019, në shumën përfundimtare : 118,282.42 €, të cilat nuk janë paguar brenda projektit për shkak të fondit të limituar por të cilat duhet të procedohen për pagesë nga burimet tjera alternative apo nga KRU “Hidroregjioni Jugor”.
- Raportit I bashkangjiten:
 1. Marrëveshja nr. 548/30.03.2018, në mes palëve të nënshkruara: KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A dhe “RaiCommerce Kosovo LLC& Infra Plus”, shoqëruar me tërë dokumentacionin tekniko – investig.
 2. Marrëveshja nr. 2573/12.10.2018, në mes palëve të nënshkruara: KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A dhe Komuna e Prizrenit, shoqëruar me tërë dokumentacionin tekniko – investig.
 3. Memorandum Miërkuptimi, nr. 1644/15.12.2016, në mes palëve të nënshkruara: KFW&MI&KK-Prizren&KRU “Hidroregjioni Jugor”, Sh.A.
 4. Zotimi nga MI, nr. 4286/11.05.2018, për përkrahje në asfaltimin e trasës të paraparë të gypsjellësit, në gjatësi; L ≈ 3.2 km.
 5. Tërë dokumentacioni përcjellës teknik, financiar, administrativ, shkëmbyes e i ngjajshëm.



15.4 Mënjanimi I ujërave të zeza në Europën Jugperëndimore. (Faza V)

Titulli I projektit;	“Inspektimi me CCTV dhe shërbimet tjera për rrjetin e kanalizimit në Prizren”.
Përfituesi;	KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren
Donatori;	Qeveria Gjermane–KFW/BMZ–2015.6705.6/Prizren – V/WC-1.3
Agjensioni financiar;	KFW – Banka zhvillimore
Fondi total i programit;	8 mln Euro
Data e Marrëveshjes;	04.10.2019
Palët e marrëveshjes;	1. KFW,
1.	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
	2. KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, Prizren
	3.KRU Hidrodrini” – Pejë
	4.KRU “Gjakova” – Gjakovë
Konsulenca;	SRP, Schneider + Partner

Hidroing-DK

Punëmarrësi; “KWE – Kosova Water and Energy” shpk, Prishtinë

Kontrata; 3551/26.11.2019

Vlera e kontratës; **612.215.00 €.**

Data e fillimit të punimeve; 13.01.2020

Plani dinamik I paraparë; 300 ditë kalendarike

Statusi i fillimit të punimeve:

Me datën 13.01.2020 është mbajtur takimi I parë konsultative me punëmarrësin – KWE, me pjesëmarrjen e konsulences dhe menaxhmentiit të Kompanisë.

Temë e takimit ishte përgatitja dhe dorëzimi I dokumentacionit final për fillimin e punimeve dhe dakordimi për datën e fillimit të punimeve në teren.

KWE është zotuar që deri me datën 20.01.2020 të përgatis dhe dorëzoj dokumentacionin e kërkuar dhe është zotuar që punimet në teren të fillojnë me datën 28.01.2020.

KRU “Hidroregjioni Jugor”, është zotuar për procedimin e dokumentacionit të duhur për aplikim në institucionet relevante për marrjen e Pëlqimeve dhe lejeve përkatëse për zhvillimin e opunimeve nga kontraktori.

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

